

# **SHTYLLAT E SHOQËRISË CIVILE:**

Bashkëpunim më efektiv ndërmjet  
sektorit të shoqërisë civile  
dhe shtetit në Shqipëri



## **AKADEMIA E OJF-ve** 2015-2018

## ***“SHTYLLAT E SHOQËRISË CIVILE: BASHKËPUNIM MË EFEKTIV NDËRMJET SEKTORIT TË SHOQËRISË CIVILE DHE SHTETIT NË SHQIPËRI -***

### **Falënderime**

Ky vlerësim është rezultat i projektit: “Shtyllat e Shoqërisë Civile: Bashkëpunim më efektiv ndërmjet sektorit të shoqërisë civile dhe shtetit në Shqipëri - Akademia e OJF-ve 2015-2018”, i zbatuar nga Partnerët Shqipëri (PSH), në bashkëpunim me Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki (PDCS) dhe financuar nga Slovak Aid – Asistenca Zyrtare për Zhvillim e Republikës së Sllovakisë.

Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionet e Slovak Aid.

Partnerët në projekt i’u janë mirënjohës të gjithë atyre që kontribuan në vlerësim nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në intervista dhe në anketim.

### **Vlerësuese e jashtme:**

Dr. Lindita Rama

2018

# **SHTYLLAT E SHOQËRISË CIVILE:**

Bashkëpunim më efektiv ndërmjet  
sektorit të shoqërisë civile  
dhe shtetit në Shqipëri



**AKADEMIA E OJF-ve**

2015-2018

## Lista e Akronimeve

<b>RV</b>	Raport Vlerësimi
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>OSHC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile
<b>KKIE</b>	Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian
<b>OJF</b>	Organizatë jofitimprurëse
<b>PSH</b>	Partnerët Shqipëri
<b>PDCS</b>	Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>ToR</b>	Termet e Referencës

# Tabela e Përmbajtjes

<b>I. KONTEKSTI I PROJEKTIT.....</b>	<b>7</b>
1.1 Zhvillimi i shoqërisë civile në Shqipëri.....	7
1.2 Kontributi i qeverisë ndaj OJF-ve.....	8
1.3 Kontributi i donatorëve ndaj OJF-ve.....	9
<b>2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....</b>	<b>10</b>
2.1 Objektivat dhe rezultatet.....	10
2.2 Aktivitetet e projektit .....	10
2.3 Strategjia e zbatimit dhe supozimet kryesore.....	10
2.4 Përfituesit e synuar dhe grupet e interesit.....	11
2.5 Manaxhimi teknik dhe administrativ.....	11
<b>3. VLERËSIMI I JASHTËM .....</b>	<b>13</b>
3.1 Qëllimi i vlerësimit .....	13
3.2 Konteksti i vlerësimit.....	13
3.3 Metodologjia e vlerësimit .....	14
<b>4. GJETJET KRYESORE FAKTIKE .....</b>	<b>15</b>
4.1 Akademia e OJF-ve.....	15
4.2 Krijimi i grupeve mbështetëse (peer coaching groups) .....	16
4.3 Krijimi i një publikimi mbi temat lidhur me çështje të pjesëmarrjes dhe kooperimit .....	16
4.4 Vizitë studimore në Sllovaki.....	17
4.5 Asistencë teknike për pjesëmarrësit e Akademisë së OJF-ve.....	17
4.6 Konferencë kombëtare.....	17
<b>5. ANALIZË .....</b>	<b>19</b>
5.1 Përshatshmëria dhe fokusi i projektit.....	19
5.2. Rezultatet e projektit dhe praktikrat e mira.....	20
5.3 Efektiviteti .....	27
5.4 Qendrueshmëria.....	28

<b>6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>29</b>
<i>Shtojca 1: Informacione kryesore mbi aktivitetet e planifikuara dhe treguesit e arritjeve.....</i>	<i>30</i>
<i>Shtojca 2: Programi i Akademisë së OJF-ve.....</i>	<i>34</i>
<i>Shtojca 3: Informacion mbi OJF-të e asistuar dhe rezultatet e arritura.....</i>	<i>35</i>
<i>shtojca 4: Dëshmi dhe raste të praktikave më të mira .....</i>	<i>36</i>
<i>Shtojca 5: Pyetësor .....</i>	<i>38</i>
<i>Shtojca 6: Lista e të intervistuarve .....</i>	<i>41</i>

## I. KONTEKSTI I PROJEKTIT

### 1.1 *Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri*

**1.1.1** Nuk ka shifra të sakta për numrin aktual të organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) të regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në Shqipëri. Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila mban regjistrin e OJF-ve, ekzistojnë 12,000 organizata, duke përfshirë shoqatat, fondacionet dhe qendrat. Megjithatë, numri total i OJF-ve aktive të regjistruara në autoritetet tatimore është vetëm 3,724<sup>1</sup>. Vetëm për vitin 2016, të dhënat tregojnë se janë regjistruar 307 OJF të reja, nga të cilat 221 janë shoqata, 60 qendra dhe 26 fondacione. Sipas një studimi të fundit të zhvilluar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), fuqia punëtore brenda sektorit përfshin 7,505 punonjës, që përbëjnë 0.72% të numrit total të të punësuarve në Shqipëri. Organizatat që punojnë në fushën e rinisë, kulturës dhe arsimit, dhe shërbimeve sociale përfaqësojnë numrin më të madh të OJF-ve aktive. Megjithatë, mungesa e informacionit zyrtar për numrin dhe të dhënat e tjera përkatëse për OJF-të, si shpërndarja gjeografike, madhësia e organizatave, numri i punonjësve, të ardhurat vjetore, burimet e financimit, statusi aktiv dhe pasiv, etj., mbetet ende problematik.

**1.1.2** Në përgjithësi, kuadri ligjor që rregullon krijimin dhe funksionimin e OJF-ve është i mirëthemeluar në shumicën e aspekteve të tij. Megjithatë, ai paraqet ende disa problematika lidhur me centralizimin e procesit të regjistrimit/çregjistrimit, në Tiranë, kostot financiare të regjistrimit, procedurat e gjata dhe mungesën e juristëve, avokatëve dhe gjyqtarëve të specializuar, që merren me çështjet ligjore të OJF-ve. Kuadri ligjor dhe rregullator për garancitë themelore ligjore të lirisë për OJF-të është përgjithësisht i harmonizuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**1.1.3** OJF-të në Shqipëri kryejnë veprimtarinë e tyre në një mjedis mjaft dinamik dhe luajnë një rol domethënës në zhvillimin e vendit nëpërmjet kompetencave të ndryshme dhe fushës së ekspertizës. Përfshirja dhe prania e sektorit në çështjet publike dhe të politikëbërjes është bërë gjithnjë e më shumë e dukshme, por ende ka vend për përmirësim në aspektin e pjesëmarrjes më efikase në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes, në përputhje me disa nga praktikat më të mira. Kuadri ligjor dhe fiskal për sektorin është subjekt i ndryshimeve të shpeshta, që ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe veprimtarinë e sektorit. Roli i OJF-ve si promotorë të ndryshimit varet nga vjetërsia në ushtrimin e veprimtarisë, kompetencat, gatishmëria dhe kapaciteti i tyre për bashkëpunim të suksesshëm me partnerët strategjikë në vend. OJF-të kanë ende nevojë për programe zhvillimi që të përmirësojnë aftësitë lidhur me zhvillimin dhe manaxhimin organizativ, qëndrueshmërinë dhe përfshirjen në proceset me pjesëmarrje.

**1.1.4** Ka disa raporte që kanë përcaktuar në mënyrë periodike statusin e zhvillimit të OJF-ve në Shqipëri. Si rrjedhojë, BTI Raporti për Shqipërinë 2016 (Bertelsmann Stiftung's Transformation Index) nënvizon rëndësinë e madhe që ka asistencën e huaj për krijimin dhe mbështetjen e një sektori të ri, duke nxitur pjesëmarrjen dhe familjarizimin e publikut me sjelljen dhe vlerat demokratike.

Disa OJF ia kanë dalë me sukses që të angazhohen në procese advokimi, në role monitorimi dhe në ofrimin e ekspertizës, në rastet kur disa institucione nuk kanë qenë në gjendje ta ofronin. Tradita e ulët e angazhimit qytetar e trashëguar nga e kaluara; ndikimi i madh politik, dhe varësia e madhe ndaj fondeve të huaja kanë krijuar një model të veçantë të aksionit qytetar, të përqëndruar te kapitali dhe të përshtatur sipas prioriteteve të donatorëve më tepër sesa tek nevojat e shoqërisë. "Freedom House", në kapitullin e Raportit "Vendet në Tranzicion" për Shqipërinë 2017 shprehej pozitivisht në vlerësimin e saj të përgjithshëm për statusin e OJF-ve, duke përmendur se grupet dhe aktivistët e shoqërisë civile kanë treguar se kanë shtuar gjallërinë, organizimin dhe angazhimin për t'iu dhënë zë shqetësimeve të tyre lidhur me çështje të ndryshme sociale dhe politike. Partnerët Shqipëri, Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2015-2016 i referohet qëndrueshmërisë financiare të OJF-ve, duke theksuar se financimet e disponueshme publike konsiderohen të pamjaftueshme për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e OJF-ve.

<sup>1</sup> IDM, indeksi i qëndrueshmërisë së OSHC-ve për vitin 2016, 2017.

Në Raportin e USAID 2016: Indeksi i Qendrueshmërisë së OSHC-ve, Shqipëria identifikohet si një vend me indeks qendrueshmërie të shëndoshë për periudhën 2014-2015-2016. Raporti konstaton se OJF-të vijojnë të bëjnë përpjekje për të përmirësuar planifikimin e tyre strategjik, forcimin e mbështetësve dhe formimin e koalicioneve, advokacinë, dhe përdorimin e teknologjive moderne; megjithatë, këto nisma nuk mjaftojnë për të sjellë ndryshime të rëndësishme dhe të qëndrueshme në mjedisin e OJF-ve në Shqipëri. Ligji për Vullnetarizmin nuk ka gjetur ende zbatim, OJF-të vijojnë të advokojnë për rregullat e duhura të raportimit financiar dhe kontabilitetit, për organizata me madhësi dhe të ardhura të ndryshme, veçanërisht për OJF-të e vogla që nuk angazhohen në veprimtari ekonomike; por ende ka një hendek në ekspertizë dhe përvojë ndërmjet OJF-ve në Tiranë dhe atyre në rrethe. Varësia nga donatorët i shtyn shumë OJF-të të ndërmarrin nisma të gjera, duke i udhëhequr drejt përgjithësimin dhe mungesës së specializimit të njohurive në fusha specifike të veprimtarisë. Shoqëria civile vijon të angazhohet në procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Megjithëse përfaqësues të OJF-ve kanë marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian (KKIE), që është një forum konsultativ i krijuar në vitin 2015 për të garantuar gjithëpërfshirjen në proceset lidhur me BE-në, Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë 2016 doli në përfundim se OJF-të nuk kishin luajtur një rol aktiv në Këshill. Në vitin 2016, imazhi publik i sektorit nuk ndryshoi shumë. Veprimtaria e OJF-ve dhe fushatat e tyre advokuese gëzojnë njëfarë pasqyrimi në media, kryesisht për ato të përqendruara te qeverisja e mirë, llogaridhënia, të drejtat e grave dhe fëmijëve, dhe te mbrojtja e mjedisit. Në përgjithësi, publiku mbështet kauza dhe fushata të veçanta, por jo sektorin në tërësi.

## 1.2 Kontributi i qeverisë ndaj OJF-ve

### Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016:

**1.2.1** Viti 2015 shënoi disa zhvillime pozitive legjislative, në lidhje me bashkëpunimin Qeveri - OJF, dhe në zhvillimin e këtyre të fundit. Në muajin maj, Qeveria e Shqipërisë miratoi "Udhërrëfyesin për Hartimin e Politikave dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile", një dokument që përfshin nëntë fusha prioritare të veprimit, të cilat synojnë ta nxisin qeverinë që të ndërmarrë një proces efikas të vendimmarrjes lidhur me krijimin e mekanizmave të reja, ose përmirësimin e atyre ekzistuese për bashkëpunimin me shoqërinë civile, me qëllim kontribuimin në nxitjen e qeverisjes me pjesëmarrje, politikëbërjes gjithëpërfshirëse dhe demokracisë më të fortë brenda vendit. Pritet që ky Udhërrëfyes të kontribuojë në bashkëpunimin më efikas ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile, si një kusht i domosdoshëm për qëndrueshmërinë dhe pakthyeshmërinë e reformave të ndërmarrura brenda kuadrit të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Nëntë fushat prioritare janë si në vijim: 1. Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile; 2. Institucionet qeveritare me mëndësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të; 3. Përfshirja e qendrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes; 4. Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në përputhje me praktikatat e mira të BE-së; 5. Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të vecantë në nivel lokal; 6. Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve; 7. Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile; 8. Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikatat e mira të BE-së; 9. Raportimi financiar, kontabilizimi dhe trajtimi tatimor i OJF-ve;

**1.2.2** Në nëntor 2015, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile", një organ kolegjal këshillimor, që synon të garantojë bashkëpunimin institucional ndërmjet shtetit dhe OJF-ve në Shqipëri për një demokraci të konsoliduar, qeverisje të mirë dhe rritje të transparencës përmes përfshirjes së shoqërisë civile në këtë proces. Krahas numrit të shtuar të konsultimeve, dhe numrit të OJF-ve të përfshira në këto procese, konsultimet ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF-ve karakterizohen ende nga mungesa e dialogut kuptimplotë dhe të zhvilluar në kohë. Pavarësisht kritereve politike, miratimi i ligjit për krijimin e KKSHC-së siguroi kuadrin për konsultime më të strukturuar me organizatat e shoqërisë civile. Transparenca dhe gjithëpërfshirja në punën e parlamentit vijoi të ndiqte një prirje në rritje kundrejt ligjit për KKSHC-në, megjithëse procesi i përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në KKSHC nuk ishte shprehimisht i përcaktuar në ligj. Përfaqësuesit e shoqërisë civile morën pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian, por roli i tyre mbeti pasiv në tërësi. Ka ende nevojë për bashkërendim dhe bashkëpunim më të ngushtë në të gjitha nivelet e qeverisë me platformat



parlamentare dhe ato të shoqërisë civile, që merren me çështjet e integritimit në BE.

Zbatimi i efektshëm i ligjeve për të drejtën e informimit dhe konsultimin publik mbeti një sfidë, veçanërisht në nivel vendor. Angazhimi i shoqërisë civile në rritjen e mostolerancës publike ndaj korrupsionit, monitorimi dhe denoncimi i korrupsionit, mbikëqyrja e performancës së organeve që luftojnë korrupsion mbetën të dobëta.

**1.2.3** Fatkeqësisht, ndryshimet në nivel legjislativ, politikash dhe strategjish nuk janë shoqëruar me zhvillime të dukshme në nivelin praktik. Si rrjedhojë, 39% e OJF-ve të anketuara u shprehën se bashkëpunimi ndërmjet shtetit dhe OJF-ve nuk është përmirësuar, 36% u shprehën se bashkëpunimi është përmirësuar paksa, dhe vetëm 25% u shprehën se ky bashkëpunim është përmirësuar. Në prill 2016, parlamenti kaloi "Ligjin për Vullnetarizmin", duke përmbushur kështu një nga nëntë prioritetet e identifikuara në "Udhërrëfyesin e Qeverisë për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile". Në përgjithësi, është shënuar njëfarë progresi në rregullimin e sektorit të tretë, por kuadri fiskal vijon të mos mbështesë nevojat dhe zhvillimin e tij. Për të trajtuar nevojat e OJF-ve, duhet përmirësuar transparenca, llogaridhënia, procedurat e aplikimit dhe përzgjedhjes për shpërndarjen e fondeve publike nga institucionet publike, duke përfshirë AMSHC-në. Shteti ka institucionalizuar njohjen e rëndësisë së zhvillimit dhe bashkëpunimit me këtë sektor.

### 1.3 Kontributi i donatorëve ndaj OJF-ve

**1.3.1** OJF-të në Shqipëri vijnë të jenë tejet të varura nga donatorët dhe përgjithësisht të udhëhequra prej tyre. Si rrjedhojë, shumë prej tyre nuk janë aktive për shkak të mungesës së fondeve apo përmbushjes së misionit të tyre fillestar, gjë që bën që numri i tyre të shtohet në mënyrë artificiale. OJF-të dhe individët në Evropë dhe Euroazi po mësojnë gjithnjë e më shumë të përshtaten me hapësirën e ngushtë qytetare, duke gjetur mënyra të reja për të advokuar, për të mobilizuar qytetarët dhe për të siguruar fonde. Qendrueshmëria e OJF-ve në shumë vende të rajonit po sfidohet gjithnjë e më shumë nga pakësimi i aksesit në financim dhe hapësira e ngushtë e veprimit, duke theksuar progresin në diversifikimin financiar përmes praktikave novatore, siç janë alternativat "crowd funding" etj.

**1.3.2** Komuniteti ndërkombëtar duhet të promovojë shembuj të praktikave të mira nga Shqipëria dhe rajoni dhe të bashkëfinancojë disa veprimtari. Përfshirja e ministrive të linjës në zbatimin e një sërë aktiviteteve ndihmon në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe OJFve për të shmangur mbivendosjen dhe paefektshmërinë e tyre. Buxhetet e donatorëve për financimin e projekteve të OJF-ve janë pakësuar gjatë viteve të fundit, dhe në disa raste janë ulur me dy të tretat gjatë dhjetëvjeçarit të fundit . Sa më shumë shqetësues të jetë largimi i donatorëve nga Shqipëria, aq më pak dialog ka ndërmjet donatorëve për të mbështetur shoqërinë civile.

Si rrjedhojë, edhe fondet që lidhen me trajtimin e nevojave të komuniteteve të marginalizuara janë më të kufizuara se më parë. BE-ja përbën një nga burimet më të rëndësishme të financimit për të ardhmen; megjithatë, është shumë e vështirë që kërkesat e saj për aplikim të përmbushen nga OJF-të lokale.

## 2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

### 2.1 Objektivat dhe përfundimet

**2.1.1** Qëllimi i përgjithshëm i projektit është mbështetja e procesit të demokratizimit dhe reformave në Shqipëri, përmes përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit të shoqërisë civile dhe atij shtetëror, drejt përmirësimit të aftësive, qëndrueshmërisë dhe transparencës, si dhe përmes forcimit të bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile, qytetarëve dhe zyrtarëve publikë. Objektivat specifike të projektit janë: (i) përmirësimi i shoqërisë civile në Shqipëri nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të organizatave të vogla dhe të mesme, dhe (ii) krijimi e marrëdhënieve të qëndrueshme me qeverinë.

**2.1.2** Rezultatet kryesore që duhen arritur nga zbatimi i projektit janë: (i) kapacitete të përmirësuara të drejtuesve të OJF-ve të vogla dhe të mesme të përzgjedhura, përmes programit “Akademia e OJF-ve”, dhe bashkëpunim i shtuar ndërmjet tyre; (ii) pjesëmarrësit e Akademisë së OJF-ve janë konsultuar për nevojat bazë të organizatave të tyre; (iii) bashkëpunim i shtuar ndërmjet pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve dhe Qeverisë, duke përmirësuar aftësitë e tyre në fushat që janë të nevojshme për bashkëpunimin me qeverinë (advokaci, lobim dhe formim koalicionesh), me qëllim shtimin e ndërveprimeve dhe veprimtarive të tyre të përbashkëta;

(iv) aftësi të përmirësuara të pjesëmarrësve të Akademisë në fusha që janë të nevojshme për bashkëpunimin me qeverinë; (v) përvojë e përfituar nga drejtuesit e OJF-ve sllovaqe dhe përfaqësues të qeverisë. Rezultatet përfundimtare të parashikuara nga zbatimi i projektit janë “projekte specifike të zbatuara si rezultat i forcimit të kapaciteteve të specializuara të drejtuesve të OJF-ve dhe informacione të reja lidhur me sektorin joqeveritar dhe qeverinë (të paktën 3), numri i kontakteve të vendosura, raste të zgjidhjes së problemeve dhe vendosjes së bashkëpunimit (të paktën 20).

### 2.2 Aktivitetet e projektit

**2.2.1** Aktivitetet kryesore të përcaktuara në projekt janë: (i) Organizimi i një serie trajnimesh për drejtuesit e OJF-ve, pjesëmarrës në Akademinë e OJF-ve gjatë periudhës 2015-2018; (ii) Përgatitja e një publikimi në tema që lidhen me bashkëpunimin midis sektorëve; shembuj të praktikave më të mira; (iii) Krijimi i grupeve mbështetëse (peer-coaching) midis pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve; (iv) Konsulencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë; (v) Organizimi i një konference në Shqipëri për ndarjen e rezultateve dhe përfundimeve kryesore të Akademisë së OJF-ve për vitin 2015; (vi) Prezantim publik i arritjeve në fund të zbatimit të projektit; (vii) Program trajnimi intensiv si një vijimësi e Akademisë për përvetësimin e aftësive të nevojshme për bashkëpunimin me sektorin qeveritar; (viii) Organizimi i vizitave studimore në Sllovaki për pjesëmarrësit e Akademisë së OJF-ve, me qëllim marrjen e njohurive dhe praktikave për bashkëpunim midis OJF-ve dhe Qeverisë, të paraprirë nga një seminar mbi vlerësimin e nevojave dhe hartëzimin e pritshmërive për vizitat. Aktivitetet kryesore të planifikuara dhe treguesit për t'u arritur janë përmbledhur në tabelën e paraqitur në Shtojcën 1 të Raportit të Vlerësimit.

### 2.3 Strategjia e zbatimit dhe supozimet kryesore

**2.3.1** Projekti është konceptuar i ndarë në dy faza: Faza e parë e aktiviteteve parashikohej të zbatohet gjatë periudhës 2015-2016, ndërsa Faza e dytë e aktiviteteve gjatë periudhës 2017-2018. Projekti fillon si në reagim ndaj marrëdhënies problematike ndërmjet sektorit jofitimprurës dhe qeveritar në Shqipëri, me disa pasoja në proceset demokratike dhe në zhvillimin e shoqërisë civile. Pas prezantimit publik të rezultateve të fazës së parë të projektit, mësimet e nxjerra dhe opinionet e përfituesve u pasqyruan në aktivitetet e planifikuara gjatë fazës së dytë. Si rrjedhojë, (i) gjatë procesit të përzgjedhjes së pjesëmarrësve për Akademinë e OJF-ve dhe hartimit të moduleve mbi temat e trajtuara, u mor në konsideratë nevoja për forcim kapacitetesh

të organizatave të vogla dhe të mesme; (ii) veçanërisht për organizatat e reja u mor në konsideratë ofrimi i asistencës teknike dhe mentorimit direkt në lidhje me proceset e brendshme të zhvillimit organizativ, sistemet financiare aktuale dhe administrimin e stafit; (iii) organizimi i konsultimeve virtuale (përmes webinar) para vizitave studimore, me qëllim përcaktimin e fokusit/interesave dhe përmbushjen e pritshmërive të pjesëmarrësve.

**2.3.2** Projekti zbatohet si përpjekje e përbashkët e PSH-së dhe PDCS-së. Ndarja e qartë e përgjegjësi ndërmjet partnerëve zbatues paraqitet në dokumentin e projektit. Supozimet kryesore të parashikuara në dokumentin e projektit janë: (i) interesi i vazhdueshëm i qeverisë në mbështetje të zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe në punën me përfaqësuesit e OSHC-ve; (ii) vullneti i drejtuesve të OJF-ve që të lënë pasardhës në sektorin e tyre; (iii) përzgjedhje cilësore e pjesëmarrësve dhe përmbajtje e përditësuar e materialeve të trajnimit për drejtuesit e OJF-ve shqiptare; (iv) gatishmëri për të ndjekur vizitat studimore dhe për të pasur njohuritë e duhura gjuhësore për t'i ndjekur ato; (v) interes për ndjekjen e seancave të asistencave dhe mentorimit; dhe interes nga ana e të ftuarve për të ndjekur konferencën.

**2.3.3** Supozime të tjera administrative të parashikuara në "Marrëveshjen e Bashkëpunimit" të nënshkruar ndërmjet dy partnerëve janë: (i) Përmbajtja e materialeve informuese të hartuara dhe të shpërndara duhet të jetë në përputhje me objektivat e projektit, dhe duhet të konsultohen dhe miratohen nga Agjencia SlovakAid, para publikimit dhe shpërndarjes së tyre; (ii) Partnerët Shqipëri iu lejojnë monitoruesve dhe vlerësuesve të SlovakAid akses në dokumentacionin lidhur me zbatimin e projektit, dhe ofrojnë asistencë për rishikimin e progresit dhe ndikimit të projektit; (iii) Në rastin e kostove shtesë të nevojshme për përfundimin e aktiviteteve, ato do të mbulohen nga Partnerët Shqipëri, që është edhe përfituesi fundor.

**2.3.4** Dokumenti i projektit ka përfshirë edhe rreziqet që mund të ndikojnë negativisht aktivitetet e projektit. Rreziqet më të rëndësishme janë: (i) Ngjarje politike të papritura; (ii) pamjaftueshmëri e sektori qeveritar, që nevojitet për të vënë në praktikë strategjinë dhe aktivitetet e reja;

## **2.4 Përfituesit direkt dhe aktorët kryesorë**

**2.4.1** Përfituesit direkt të këtij projekti përfshijnë: (i) OJF-të shqiptare në mbarë vendin, të cilat mund të përfitojnë nga një seri leksionesh gjatë Akademisë së OJF-ve, ndërmjet ndarjes së përvojave me njëri-tjetrin, si dhe nga të nxënit përmes përvojave transformuese të Sllovakisë në fushën e edukimit, dhe thellimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit qeveritar dhe atij jofitimprurës. (ii) Drejtuesit e OJF-ve, për të cilët kjo është një mundësi e jashtëzakonshme që të përparojnë me profesionalizmin e tyre dhe të bëhen aktorë të ndryshimit; (iii) Frymëzimi dhe nxitja e përfaqësuesve të sektorit qeveritar për forma të reja të bashkëpunimit me sektorin jofitimprurës, me qëllim shtimin e ndërveprimeve dhe veprimtarive të tyre të përbashkëta.

**2.4.2** Përfituesit dytësorë të projektit përfshijnë: (i) OJF të tjera që do të punojnë dhe bashkëpunojnë me organizata me më shumë përvojë dhe njohuri; (ii) Donatorët që do të bashkëpunojnë me OJF-të që kanë performancë më të mirë, dhe do të marrin propozime më të mira për financim; (iii) Institucione vendimmarrëse qendrore dhe vendore që do të kenë pjesëmarrje të lartë dhe kontribut cilësor nga shoqëria civile gjatë proceseve vendimmarrëse; (iv) Komunitetet vendore dhe shoqëria në përgjithësi, që do të përfitojnë nga veprimtari më të mirëplanifikuara dhe të mirëzbatuara.

## **2.5 Manaxhimi teknik dhe administrativ**

**2.5.1** Projekti manaxhohet nga ana teknike si nga stafi i PSH-së, ashtu edhe nga stafi i PDCS-së. PSH-ja ka emëruar manaxherin e projektit - përgjegjës për manaxhimin e projektit në Shqipëri, asistentin e projektit - përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve, si dhe manaxherin e financës - përgjegjës për raportimin financiar të PDCS-ja.

Partnerët Sllovakia ka emëruar manaxherin e projektit - përgjegjës për manaxhimin e përgjithshëm të projektit/ administrimin e tij, pra për raportimin të SlovakAid (raportim përshkrues/raportim i ndërmjetëm dhe përfundimtar) lidhur me koordinimin me stafin administrativ shqiptar për zbatimin pa probleme të projektit, etj., si dhe manaxherin

e financës - përgjegjës për kontrollin e raporteve financiare të Partnerëve Shqipëri dhe raportimin financiar te SlovakAid për të dy partnerët e projektit.

Plani i aktiviteteve është hartuar dhe zbatuar si kontribut i të dyja organizatave. PSH-ja i ka dërguar PDCS-së raporte dy-mujore financiare dhe të aktiviteteve.

## 3. VLERËSIMI I JASHTËM

### 3.1 Qëllimi i vlerësimit

**3.1.2** Qëllimi kryesor i këtij Raporti Vlerësimi të jashtëm përfundimtar (RV) është analizimi i arritjeve të projektit, duke iu vënë në dispozicion partnerëve të projektit shqyrtimin e pavarur të përfundimeve të tij. Qëllimi i vlerësimit është përqendruar në vlerësimin tërësor të aktiviteteve të zbatuara në afatin kohor janar 2015 - prill 2018, duke paraqitur efikasitetin, ndikimin, dhe duke dhënë rekomandime për qëndrueshmërinë në të ardhmen. Më konkretisht, vlerësimi do të përqendrohet në objektivat e mëposhtme: (i) vlerësimin e rezultateve të projektit krahasuar me synimet dhe objektivat fillestare të planifikuara; (ii) identifikimin e faktorëve që kanë mundur ose penguar arritjen e objektivave; (iii) vlerësimin e përshtatshmërisë, efektshmërisë dhe qëndrueshmërisë së projektit; (iv) vlerësimin e ndikimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në efektshmërinë e projektit; (v) vlerësimin e efikasitetit dhe përshtatshmërisë së marrëveshjeve për manaxhimin e projektit (p.sh. bashkëpunimi me ekspertët sllovakë); (vi) identifikimin e mësimave të nxjerra dhe praktikave të mira lidhur me zbatimin e projektit dhe partneritetet, etj.

**3.1.3** Gjetjet dhe rekomandimet e RV-së do të përcaktojnë cilat janë rezultatet e arritura të projektit dhe nëse projekti ka mundur të adresojë çështjet e qëndrueshmërisë së rezultateve. Pritet që rekomandimet të përdoren nga partnerët e projektit, përkatësisht Partnerët Shqipëri (PSH) dhe Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki (PDCS), për të orientuar modelimin dhe zbatimin e programeve të tyre të ardhshme, si dhe nga drejtuesit e OJF-ve dhe organizatat e tjera si udhëzues në bashkëpunimin e tyre në të ardhmen dhe në shkëmbimin e përvojave me njëra-tjetrën dhe me institucionet qeveritare, si dhe në përpjekjet e tyre për ngritjen e fondeve në të ardhmen. Më konkretisht, ato do të shërbejnë si udhëzues për: (i) njohjen e situatës aktuale lidhur me zhvillimet e arritura në nivel qendror dhe vendor për sa iu përket OJF-ve dhe marrëdhënieve të tyre me qeverinë; (ii) të kuptuarit e situatës aktuale të kapaciteteve të OJF-ve dhe çështjeve për tu adresuar, që mund të sjellin organizata me performancë më të mirë; (iii) kuptimi më i mirë i rolit që duhet të kenë organizatat e shoqërisë civile në bashkëpunimin me qeverinë dhe komunitetet; (iv) formulimin e projekte propozimeve të reja dhe kërkesave për financime për të mbështetur ndërhyrjet e ardhshme në fushat e misionit të tyre.

### 3.2 Konteksti i vlerësimit

**3.2.1** Projekti është konceptuar nga PSH-ja dhe PDCS-ja, dhe nisur nga kjo, zbatimi është ndarë në dy faza, dhe secila prej tyre mbështetet përmes marrëveshjes së bashkëpunimit dhe asaj financiare, të nënshkruar nga të dy partnerët, si në vijim: (i) Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet PSH-së dhe PDCS-së për zbatimin e projektit “Liderët e OJF-ve për partneritetet dhe bashkëpunim më të mirë”, e nënshkruar në shtator të vitit 2015, e cila mbulon periudhën tetor 2015 - dhjetor 2016, dhe (ii) Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet PSH-së dhe PDCS-së për zbatimin e projektit “Shtyllat e shoqërisë civile: Bashkëpunim më efikas ndërmjet sektorit të shoqërisë civile dhe shtetëror në Shqipëri”, e nënshkruar në nëntor të vitit 2016, e cila mbulon periudhën janar 2017 - prill 2018. Shuma totale e fondeve për zbatimin e të dyja fazave arrin vlerën prej 63,259 Euro.

**3.2.2** Ky vlerësim kryhet në kohën kur përfshirja dhe prania e sektorit të shoqërisë civile në çështjet publike dhe komunitare është gjithnjë e më shumë e dukshme, dhe kur roli i tij është i domosdoshëm për shumë çështje të rëndësishme dhe të ndjeshme, që gjithmonë e më shumë kanë nevojë për OJF me imazh pozitiv, me identitet të qartë dhe të konsoliduar, dhe që janë të besueshme për publikun. Vlerësuesi konstatoi interesin dhe gatishmërinë për bashkëpunim nga ana e përfaqësuesve të OJF-ve, që morën pjesë në Akademinë e OJF-ve, përfaqësuesve të qeverisë të përfshirë në projekt, si dhe nga ana e aktorëve të tjerë të konsideruar si të rëndësishëm për procesin e vlerësimit. Manaxheri i PSH-së dhe stafi i zbatimit treguan mirëkuptim për të marrë pjesë dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të vlerësimit. Opinione dhe informacionet e tyre ishin të rëndësishme gjatë mbledhjes së informacionit dhe analizës së situatës dhe rezultateve.

## 3.3 Metodologjia e vlerësimit

**3.3.1** Vlerësimi u bazua në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit, e cila përfshiu: (i) të dhënat e marra nga dokumentet e projektit, dhe nga burime të tjera alternative, publike dhe të OJF-ve. Kjo lidhet veçanërisht me vlerësimin e rezultateve të planifikuara kundrejt atyre aktuale të projektit, kundrejt të dhënave dhe informacioneve që vijnë nga burime të ndryshme. Si rrjedhojë, të dhënat dhe informacionet u ofruan nga Partnerët Sllovaki dhe Partnerët Shqipëri, siç është dokumenti i projektit dhe matrica e kuadrit logjik, progres raportet dhe raportet përfundimtare, thirrjet e hapura për pjesëmarrje në Akademi, kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve të Akademisë, dokumentet teknike të projektit, duke përfshirë materialet e trajnimeve, botimet, formularët e vlerësimit të aktiviteteve të plotësuara nga pjesëmarrësit; (ii) dokumente të ndryshme si Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, Raporti i BTI-së për Shqipërinë 2016, Raporti i “Freedom House” për Shqipërinë 2017, Raporti i USAID-t për Indeksin e Qëndrueshmërisë së OJF-ve, etj., të cilat e ndihmuan vlerësuesin të njëjët me mjedisin e projektit dhe përshtatshmërinë e aktiviteteve të tij; (iii) informacione nga burime të ndryshme të disponueshme lidhur me nivelin e bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve dhe qeverisë qendrore dhe vendore, pas përmbylljes së fazës së parë të projektit, si dhe përpjekjet e OJF-ve për advokaci dhe lobim lidhur me tema të rëndësishme për interesin publik. (iv) dokumente të tjera lidhur me rolin që ka luajtur shoqëria civile në tre vitet e fundit, si pjesë e përpjekjeve të vendit për t’u integruar në BE.

**3.3.2** Në kuadër të aktiviteteve të projektit, u kryen intervista ballë për ballë me përfaqësues të asistuar/ trajnuar të OJF-ve, përfaqësues të qeverisë që janë përjasur në projekt për të asistuar në përpjekjet e rrjetëzimit me OJF-të, drejtues ekzekutive dhe nga poste të tjera manaxheriale të OJF-ve pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, lektorë të PSH-së, etj.

Çështjet kryesore që u diskutuan me ta janë: (i) Perceptimi i OJF-ve në aspektin e ndikimit të projektit dhe angazhimit të tyre në çështjet e shoqërisë civile; (ii) A janë pjesëmarrësit e OJF-ve në Akademi të kënaqur me nivelin e cilësisë së leksioneve dhe asistencës së ofruar, dhe si kanë ndikuar këto në performancën dhe përmirësimin e organizatës së tyre; (iii) A kanë besim përfaqësuesit e qeverisë për të bashkëpunuar me këto OJF në të ardhmen; dhe (iv) Çështjet prioritare kryesore për ndërhyrje në të ardhmen dhe cilat praktika të mira dhe përfitime theksuan ata.

**3.3.3** Për të kuptuar më mirë perceptimin e përfituesve direktë në projekt, lidhur me përfundimet e projektit, u krye një anketim cilësor (Shtojca 5). Pyetëtori u konceptua për t’u plotësuar në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës “survey monkey”, dhe iu dërgua 42 pjesëmarrësve në Akademinë e OJF-ve, atyre që nuk morrën pjesë në intervistat ballë për ballë. Anketimi u plotësua nga 27 të anketuar. Gjetjet kryesore të intervistave ballë për ballë dhe anketimit ishin themelore për të ballafaquar gjetjet gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, të përfshira në Kapitullin 4 të kësaj RV-je, dhe për të kryer një analizë të plotë nisur nga pikëpamjet e përfituesve. U kontaktua gjithashtu edhe kryetari i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Gjithashtu, u krye edhe një kërkim në “Google” për veprimtaritë e zbatuara nga OJF-të pjesëmarrëse në projekt gjatë periudhës 2016 dhe në vijim, për të mundësuar një vlerësim të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të OJF-ve me objektivat e aktiviteteve të projektit.

## 4. GJETJET KRYESORE FAKTIKE

### 4.1 Akademia e OJF-ve

**4.1.1** Gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të projektit, PSH ka shpallur 4 (katër) “Thirrje për Aplikime” për të marrë pjesë në Akademinë e OJF-ve, përkatësisht: (i) Akademia e OJF-ve (1) e shpallur në shkurt 2015, kohëzgjatja e programit mars - nëntor 2015, numri total i pjesëmarrësve të përzgjedhur 18; (ii) Akademia e OJF-ve (2), e shpallur në shkurt 2016, kohëzgjatja e programit mars - nëntor 2016, numri total i pjesëmarrësve të përzgjedhur 22; (iii) Akademia e OJF-ve (3), e shpallur në shkurt 2017, kohëzgjatja e programit shkurt - korrik 2017, numri total i pjesëmarrësve të përzgjedhur 15; (iv) Akademia e OJF-ve (4), e shpallur në qershor 2017, kohëzgjatja e programit shtator 2017 - mars 2018, numri total i pjesëmarrësve të përzgjedhur 15.

Akademia e OJF-ve u promovua në të gjitha kanalet e komunikimit, si përmes buletinit informativ të PA, emailit, Facebook-ut, faqes së internetit, LinkedIn, Google +, etj., dhe aplikantëve të interesuar iu kërkua të aplikonin nëpërmjet një “Formulari Aplikimi dhe një Letre Motivimi”.

**4.1.2** Falë një broshure të veçantë, aplikantët e interesuar u njohën me informacione lidhur me procesin e aplikimit, kriteret e pranueshmërisë dhe përzgjedhjes. Kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve përfshinë: pjesëmarrësit të ishin Drejtorë Ekzekutiv, përfaqësues të Bordit të Drejtorëve, apo pozicione të tjera të larta manaxheriale; OJF të reja dhe me përvojë, të angazhuara për të ndjekur një seri prej 10 leksionesh, seancat konsultuese dhe të gjitha aktivitetet e tjera të planifikuara, që janë prezantuar në program; të kishin njohuri të gjuhës angleze të folur dhe shkruar, duke qenë se shumica e rasteve studimore, literaturës dhe materialeve të tjera mbështetëse ishin në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht. Broshura ofronte edhe informacion të përgjithshëm lidhur me tendencat e zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri dhe nevojat aktuale, informacion për objektivin kryesor të Akademisë së OJF-ve, informacion për arritjet gjatë Akademive të mëparshme të OJF-ve si një mundësi për të përvetësuar njohuri më të mira për drejtuesit e OJF-ve, bashkëpunimin, rrjetëzimin dhe partneritetin me OJF-të e tjera shqiptare dhe të huaja, si dhe mbi Programin e plotë të Akademisë.

**4.1.3** Pjesëmarrësit e Akademisë u përzgjedhën pas secilit raund aplikimesh nga Komisioni Përzgjedhës, i përbërë nga Drejtori i PSH-së, 2 Drejtorë Programesh dhe Drejtori i Trajnimeve. Nga 166 aplikantë për të katërta Akademitë, 70 pjesëmarrës u kualifikuan si ndjekës. Numri i aplikimeve për secilën thirrje tregon se interesi për këtë program ka qenë vazhdimisht i madh. Pjesa më e madhe e OJF-ve të kualifikuara për të ndjekur Akademinë ishin ato me seli në Tiranë. Informacioni i kërkuar për veprimtaritë e organizatave me qendër në Tiranë, që morën pjesë në Akademi, tregon se shumica e OJF-ve janë aktive në mbarë vendin. Akademia u ndoq edhe nga organizata nga qytete të tjera, si: Puka, Lezha, Kukësi, Berati, Elbasani, Durrësi, Gjirokastra, etj. OJF-të që e ndoqën atë kanë një spektër të gjerë fokusi në punën e tyre, si: gratë, të rinjtë, mjedisin, zhvillimin lokal, etj. Akademia u ndoq edhe nga drejtues/manaxherë të think-tank-eve të njohura si: Instituti për Kërkim dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), Agenda Institute, Instituti Shqiptar i Shkencës, etj., që njihen për përvojën e tyre të gjatë dhe profesionale në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

**4.1.4** U zhvilluan 10 kurrikula për pjesëmarrësit e secilës Akademi (shihni shtojcën 2). Përzgjedhja e kurrikulave u bazua në njohuritë dhe përvojën e madhe të PSH-së lidhur me nevojat e organizatave të shoqërisë civile, fushat e interesit të organizatave të shprehura në kuadër të programeve të ndryshme të PSH-së, si dhe në gjetjet e raporteve të ndryshme të vlerësimit lidhur me problemet kryesore me të cilat përballet sektori. Programi i kurrikulave ndryshon paksa pas Akademisë së Parë, për shkak të modifikimeve të kryera bazuar në opinionet e të diplomuarve të Akademisë së Parë. Si rrjedhojë, kurrikula e prezantuar së fundmi ishte “Qeverisja me pjesëmarrje dhe teknikat e pjesëmarrjes”. Gjatë 3 Akademive të tjera nuk është vënë re asnjë ndryshim në kurrikulat e zhvilluara. Lektorët kanë integruar konceptet e orientimit, edukimit dhe zhvillimit të aftësive praktike. Krahas secilit modul, lektorët iu kanë ofruar pjesëmarrësve një sërë materialesh mbështetëse për lexim, lidhur me kuadrin ligjor për secilën temë, modele për përgatitjen e dokumenteve strategjike nga organizatat, plane advokacie dhe lobimi, plan komunikimi, modele për përgatitjen e manualit të politikave

dhe procedurave, etj. Lektorët janë shprehur se synonin t'i organizonin seancat në mënyrë që të mund të maksimizonin rezultatet për efektshmërinë e programit; duke nxitur konkurrencën ndërmjet pjesëmarrësve përmes promovimit të ndërveprimit dhe potencialit të dinamikës së grupit, si dhe për të ofruar trajnim të personalizuar ku është e përshtatshme.

Nga 10 kurrikula të zhvilluara, temat mbi Advokacinë dhe Lobimin; Ndërtimin e Koalicioneve dhe Rrjeteve; Sigurimin e Fondeve dhe Filantropinë; u zhvilluan nga trajnerët e PDCS-së, ndërsa pjesa tjetër nga trajnerët e PSH-së. Të tria temat e trajnimit u zhvilluan nga 2 trajnerë të PDCS-së në një trajnimi intensiv 3-ditor me qëllim rritjen e kapaciteteve të grupit për aftësitë e nevojshme, lidhur me ndërtimin e rrjeteve dhe formimin e koalicioneve, dhe zbatimin e fushatave të advokacisë dhe lobimit. Praktikrat më të mira sllovaqe ishin qëllimi kryesor i programit të trajnimit intensiv. Gjatë Akademisë së OJF-ve, pjesëmarrësit e Akademive të mëparshme, u ftuan të ndanin përvojat e tyre me pjesëmarrësit. U ftuan edhe përfaqësues të qeverisjes vendore, si nga Vlora, Durrësi, Puka, etj.

**4.1.5** Në përfundim të Programit të plotë të Akademisë, pjesëmarrësve iu kërkua të kryenin një test që shërbente për vlerësimin e njohurive të fituara gjatë Akademisë, dhe si një instrument vetëvlerësues për aspekte të ndryshme të organizatave të tyre. Disa nga temat e vlerësuara lidheshin me qartësinë e misionit, vizionit të organizatës, dokumentet e politikave dhe procedurave të brendshme të organizatës; mekanizmat dhe treguesit e performancës etj. Në veçanti, organizatat e reja kanë identifikuar si pikë të dobët të tyre mungesën e planit strategjik, procedurat e brendshme të paqarta, mungesën e planit të ngritjes së fondeve, dhe planit të advokacisë, rrjedhimisht asistencë e PSH-së nëpërmjet seancave të trajnimit u konsiderua mjaft e vlefshme. Testi përmbante pyetje për njohuritë kryesore që lidheshin me temat e trajtuara, që ishin të rëndësishme për pjesëmarrësit e Akademisë. Rezultatet e testit treguan se pjesëmarrësit ishin përgjigjur saktë në më shumë se 85% të pyetjeve.

## 4.2 Krijimi i grupeve këshilluese/mbështetëse (peer coaching)

**4.2.1** Gjatë fazës së parë u mbajtën 4 seanca këshillimi/mbështetjeje për pjesëmarrësit e Akademisë, me qëllim motivimin e krijimit të rrjeteve ndërmjet pjesëmarrësve në Akademinë e OJF-ve, të cilët diskutuan rreth sfidave të tyre. Seancat e këshillimit/mbështetjes ishin konceptuar si vijim i leksioneve të dhëna në Akademi. Pjesëmarrësit u njohën me qëllimin, rregullat, çfarë është këshillimi/mbështetja, kalendarin e mbledhjeve, etj. Secila seancë fillonte me një prezantim nga lehtësuesi lidhur me: (i) rolin e drejtuesit të OJF-së, mosmarrëveshjet në nivel organizativ, manaxhimin e stresit në punë, dilemat e vendimmarrjes, manaxhimin e detyrave të shumta dhe shterrjen (burnout); shprehjen efektive të kritikave; etj. (ii) qëndrueshmërinë organizative, sfidat e ngritjes së fondeve dhe diversifikimin e tyre, si dhe ndikimin e Akademisë së OJF-ve në zhvillimin e organizatës, qëndrueshmërinë, vizibilitetin dhe marrëdhëniet me publikun. Pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre lidhur me rolin e drejtuesit në OJF, rolin e Bordit, konfliktin e interesit, komunikimin me stafin, etj. Gjatë seancave, pjesëmarrësit reflektuan për situatat e tyre të vështira brenda organizatave, dhe ndanë histori me njëri-tjetrin. Pjesëmarrësit ishin të hapur dhe shqyrtuan opsione se si të zgjidhnin çështjet e sipërpërmendura brenda organizatës.

**4.2.2** Janë 15 OJF ato që përfituan nga këto seanca. Disa nga temat e trajtuara nga ekspertët e PSH-së ishin përgatitja e strategjisë së zhvillimit për organizatën, hartimi i strategjisë së komunikimit, hartimi/përgatitja e projekt propozimeve, hartimi i politikave dhe procedurave të brendshme, plani i sigurimit të fondeve, etj. Ekspertët e PSH-së punuan me manaxherët e organizatave, por çështjet e veçanta u diskutuan edhe me audiencën më të gjera.

## 4.3 Krijimi i një publikimi mbi temat lidhur me çështje të pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit

**4.3.1** “Zhvillimi, Qëndrueshmëria dhe Përfshirja e OJF-ve në Proceset me Pjesëmarrje” është një udhëzues i publikuar për të ndihmuar drejtuesit e OJF-ve që marrin pjesë në Akademi, të pajisen me informacione të thelluara lidhur me katër tema: (i) zhvillimi, qeverisja dhe manaxhimi organizativ, (ii) ngritja e fondeve; (iii) advokacia; (iv) pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje. Qëllimi i përgatitjes së këtij udhëzuesi ishte mbështetja e kurrikulës së zhvilluar në Akademi. Për secilën temë të udhëzuesit u miratua një kuadër teorik i kombinuar me



shembuj konkretë dhe praktikë, që e bëri më të lehtë për lexuesit që të kuptonin dhe të ushtronin njohuritë e fituara. Autorët e këtij publikimi janë një ekspert i PSH-së dhe 3 ekspertë të PDCS-së. Udhëzuesi iu shpërnda pjesëmarrësve të Akademisë si material për lexim. Ai u publikua online në faqen e internetit të PSH-së.

#### **4.4 Vizita studimore në Sllovaki e pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve**

**4.4.1** Gjatë 2 fazave të projektit, u organizuan 5 vizita studimore në Sllovaki, ku morën pjesë 68 pjesëmarrës të Akademisë së OJF-ve. Qëllimi i secilës vizite ishte t’iu ofronte pjesëmarrësve modele dhe praktika të suksesshme lidhur me bashkëpunimin midis qeverisë vendore dhe OJF-ve. Vizitës iu bashkuan edhe përfaqësues të qeverisjes vendore nga Vlora, Durrësi dhe Puka. Ata u informuan për veprimtarinë e OJF-ve, grupimet qytetare dhe institucionet publike në disa qytete si Bratislavë, Banska Bistrica, Zvolen, etj. Takimet me OJF-të dhe institucionet publike i ndihmuan pjesëmarrësit të mësonin për bashkëpunimin, praktikat novatore lidhur me luftën kundër korrupsionit, teknika të ngritjes së fondeve, buxhetimin me pjesëmarrje, etj. PDCS-ja luajti një rol thelbësor lidhur me aspektet e organizimit të vizitave studimore. Përshtypjet për vizitat studimore dhe përfitimet u diskutuan edhe gjatë takimeve të grupeve mbështetëse / këshilluese. Vizitat studimore në Sllovaki sollën më shumë komunikim midis pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve, dhe nxitën hapjen në një shkallë të madhe të diskutimeve mes tyre.

**4.4.2** Pjesëmarrësit në vizitat studimore organizuan takime me: “Qendrën Komunitare të Familjes” për të diskutuar rreth: aktiviteteve për të rinjtë, për nënat dhe familjet, arsimin, bashkëpunimin me qeverinë vendore”; takime me “Aleancën e Grave në Sllovaki” për të diskutuar për të drejtat dhe fuqizimin dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave të abuzuara; takime me organizatën “Aleanca Fair Play” për të diskutuar rreth aktiviteteve novatore kundër korrupsionit, monitorimit të shpenzimeve të financave publike; me nismën “Inakost” për të diskutuar rreth organizatave LGBTI në Sllovaki; me “Qendrën Civile të Advokacisë dhe Mbështetjes Psikologjike” në Zvolen për të diskutuar për qendrën komunitare, qendrën për nënat, bashkëpunimin dhe vullnetarët; me “Qendrën Kulturore Zahrada” për të diskutuar promovimin e veprimtarive kulturore, koncerteve, teatrit; me “Qendrën Komunitare - Qytet i Shëndetshëm” për të diskutuar rreth modelit të qendrës komunitare dhe sigurimit të fondeve në nivel lokal; me “Këshillin e të Rinjve Sllovaki” për të diskutuar rreth veprimtarive të të rinjve, çmimet për të rinjtë, bashkëpunimin me bashkitë etj.

**4.4.3** Vizitat studimore gjatë fazës së dytë të Akademisë u paraprinë nga dy seanca konsultimi virtual (webinar), e organizuar dhe moderuar nga ekspertët e PDCS-së. Ideja e organizimit të një seance të tillë ishte produkt i mësimave të nxjerra pas fazës së parë të zbatimit të projektit, me qëllim përmirësimin e fokusit të vizitës dhe rritjen e dobisë së saj për organizatat. Seancat u zhvilluan 2 muaj para vizitave studimore.

#### **4.5 Asistencë teknike për pjesëmarrësit e Akademisë së OJF-ve**

**4.5.1** PSH-ja ka ofruar asistencë teknike për 15 OJF / 1 deri në 2 ditë secila, për të garantuar zbatimin e njohurive dhe kompetencave të fituara gjatë Akademisë, në përgjigje të nevojave të organizatave të tyre. OJF-të u ftuan përmes një thirrjeje të hapur për të shprehur interesin e tyre për asistencë teknike sipas çështjes së tyre të interesit. Asistenca e ofruar ishte konkrete: asistencë për përmirësimin e projekt propozimeve të përgatitura për t’u aplikuar në thirrje të donatorëve të ndryshëm, për të zhvilluar strategji dhe mjete komunikimi për të siguruar vizibilitet të mirë të punës së tyre, udhëzime për përgatitjen e planit strategjik, mjetet për një strategji komunikimi efektive ndërmjet anëtarëve, komunitetit, qeverisë vendore dhe palëve të tjera të interesit (Shihni Shtojcën 3). Seancat ishin ndërvepruese dhe me pjesëmarrje, duke përdorur një gamë të gjerë teknikash, si prezantimi i situatave/dokumenteve/strategjive aktuale, rrahje mendimesh, ndarja e përvojave nga organizatat me eksperiencë, etj.

#### **4.6 Konferenca Kombëtare**

**4.6.1** Është organizuar Konferenca Kombëtare “Krijimi i një mjedisi mundësues dhe forcimi i kapaciteteve për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri”, ku u diskutuan gjetjet dhe rekomandimet nga matrica e monitorimit të mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Akademia e OJF-ve u prezantua si një

program novator për krijimin e organizatave efikase në dobi të publikut dhe grupeve të interesit. Të pranishëm në konferencë ishin më shumë se 60 pjesëmarrës, përfaqësues të qeverisë dhe institucioneve shtetërore, qeverisjes vendore, donatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri dhe Sllovaki. Në bazë të përvojave dhe mësimëve të nxjerra lidhur me temat e Akademisë së OJF-ve, u mor parasysh nevoja për konsultim dhe jo thjesht për seanca keshillimi /mentorimi, dhe nevoja për konsultime virtuale (webinar) përpara vizitave studimore, të cilat u reflektuan në aktivitetet e ardhshme.

## 5. ANALIZË

### 5.1 Përshtatshmëria dhe fokusi i projektit

**5.1.1** Zbatimi i Projektit “Shtyllat e Shoqërisë Civile: Bashkëpunim më efikas ndërmjet sektorit të shoqërisë civile dhe shtetëror në Shqipëri - Akademia e OJF-ve - 2015-2018” është vlerësuar si shumë i përshtatshëm për situatën dhe nevojat aktuale të sektorit të shoqërisë civile dhe shoqërisë në përgjithësi. Analiza e kontekstit shqiptar lidhur me gjendjen e zhvillimit të shoqërisë civile nisur nga perspektivat e raporteve të ndryshme, problemet me të cilat ajo përballet dhe rolin që ajo do të luajë në stadin aktual të zhvillimit janë argumente shumë të favorshme për aktivitetet e zbatuara.

Gjithashtu, gjatë procesit të intervistave u përdorën edhe argumente të tjera për përshtatshmërinë e projektit, si në vijim: (i) reformat historike që po zbaton Shqipëria, si reforma në drejtësi dhe reforma kundër korrupsionit, të cilat kërkojnë kontribut real nga organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht në rolin e tyre advokues dhe mbikëqyrës; (ii) lufta kundër korrupsionit, dhe rritjes së transparencës ka qenë në vëmendje të përpjekjeve të qeverisë gjatë katër viteve të fundit. Për shkak të dobësisë financiare, mungesës së fondeve për të mbuluar kostot institucionale të organizatës, dhe mungesës së kapaciteteve të brendshme, shumë OJF hasin vështirësi në përmbushjen e kërkesave të raportimit dhe pagesës së taksave. Në një situatë të tillë, shumë OJF janë të interesuara dhe po i kushtojnë vëmendje të veçantë përmirësimit të procedurave dhe rregulloreve të brendshme, rritjes së kapaciteteve të drejtuesve të tyre dhe financierëve të punësuar/nënkontraktuar për shërbime të manaxhimit financiar, (iii) në muajin Prill 2018, Komisioni Evropian i rekomandoi Këshillit të Evropës hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave për anëtarësim e çon axhendën e shoqërisë civile në një nivel më të lartë, që kërkon kontribut thelbësor përmes aktiviteteve të lobimit, advokacisë dhe mbikëqyrjes në nivel kombëtar dhe vendor për të adresuar çështjet e korrupsionit, krimin të organizuar, kohezionit ekonomik dhe social, si dhe ngritjen e kapaciteteve në aplikimin për fonde dhe manaxhim projektsh. Të intervistuarit mendojnë se bashkëpunimi me PDCS-në, që është një organizatë nga një vend anëtar i BE-së, është shumë i mirë edhe për faktin se ajo ka njohuri dhe përvojë me proceset dhe rrugën e integritit në BE.

**5.1.2** Zyrtarët qeveritarë të intervistuar konfirmojnë përshtatshmërinë e aktiviteteve të projektit. Sipas tyre, organizatat e reja janë pasive në lidhje me institucionet qeveritare, kryesisht për shkak të mungesës së ekspertizës së mirë, opinionit se sugjerimet e tyre nuk merren parasysh në dokumentet e miratuara të politikave, etj. Ndërkohë që marrëdhëniet në nivel vendor deklarohen sikur janë më të thjeshta, për shkak të lidhjeve personale ndërmjet personave të të njëjtit komunitet. Megjithatë, ata sugjerojnë se si qeveria edhe organizatat duhet të ndihmohen dhe të promovohen për të vendosur kontakte dhe bashkëpunim, dhe rritja e njohurive ndërpersonale për njëri-tjetrin është hapi i parë drejt kësaj.


**5.1.3** Duke marrë në konsideratë çështjen e qendrueshmërisë organizative, të intervistuarit theksuan se vitet e fundit donatorët dhe institucionet e tjera financiare kanë punuar për krijimin e një kulture të re financimi në alokimin e fondeve. Ata kërkojnë gjithnjë e më shumë të mbështesin organizatat e mirëmanaxhuara dhe transparente me profile dhe arritje, që imponojnë respekt tek komunitetet lokale dhe që merren seriozisht në konsideratë nga institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore. Të intervistuarit treguan përputhshmërinë midis aktiviteteve të kryera të projektit, të cilat përmbushën në shkallë të gjerë pritshmëritë që ata kishin në fazën e aplikimit.

**5.1.4** Të intervistuarit i kategorizojnë aktivitetet e zbatuara në tre grupe: (i) aktivitete që rrisin kapacitetet manaxheriale dhe organizative bazuar në standardet e qeverisjes së brendshme, duke përfshirë strukturat e brendshme, manaxhimin financiar, transparencën; (ii) aktivitete që forcojnë kapacitetet për të advokuar dhe bashkëpunuar me qeverinë dhe institucionet publike; (iii) aktivitete që trajtojnë çështjet e qendrueshmërisë financiare, duke përfshirë diversifikimin e të ardhurave, që nënkupton tarifa anëtarësimi nga burime publike dhe private, krahas fondeve të donatorëve. Pothuajse të gjithë të intervistuarit, që janë pjesë e organizatave të krijuara së fundmi, deklarojnë se grupi i parë i aktiviteteve mundëson një sërë njohurish, që mund të aplikohen

në organizatat e tyre, ndërsa njohuritë e fituara nga dy grupet e tjera të aktiviteteve mund të zbatohen në një qëllim më të kufizuar. Ata konstatojnë se temat e zhvillimit organizativ, planifikimit strategjik, komunikimit strategjik dhe ngritjes së fondeve ishin shumë të thelluara për t'u përthithur nga përfaqësuesit e organizatave të krijuara rishtazi dhe atyre të vogla, duke qenë se shumë prej tyre kanë mungesë njohurish dhe aftësish për hartimin e dokumenteve strategjike lidhur me tema, si: hartimi i rregulloreve dhe procedurave të brendshme; hartimi i një plani strategjik; hartimi i një plani për ngritjen e fondeve, strategjia e komunikimit të brendshëm, etj.

**5.1.5** Lidhur me përfituesit kryesorë, OJF-të pjesëmarrëse në Akademi në përgjithësi, dhe drejtuesit e rinj të OJF-ve në veçanti, mund të themi se ishin ata që përfituan më shumë nga aktivitetet e projektit. Numri i madh i sesioneve të trajnimit, asistencës teknike dhe mentorimit synonin posaçërisht këto grupe. Intervistat ballë për ballë ofruan një perceptim të fortë në këtë aspekt, ndërsa rezultatet e anketimit tregojnë qartësisht këtë. (Shihni Grafikon 1).

## Grafiku 1



Përfaqësuesit e qeverisë vendore janë grupi i dytë që përfitoi nga projekti. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të qeverisë vendore nga bashkitë shqiptare në vizitën studimore në Sllovaki; pjesëmarrja e zyrtarëve të ndryshëm të qeverisë vendore dhe zyrtarë të tjerë nga qeveria qendrore në Konferencën Kombëtare të mbajtur në Shqipëri; takimet e përfaqësuesve shqiptarë të Akademisë së OJF-ve me përfaqësues të ndryshëm të qeverisë vendore dhe qendrore kontribuan në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve. Gjithashtu, gjatë muajve të zbatimit të Akademisë së OJF-ve, 3 OJF pjesëmarrëse në program advokuan dhe lobuan për zbatimin e buxhetimit me pjesëmarrje në dy bashki - Durrës dhe Pukë (përfaqësues të këtyre dy bashkive ishin pjesë e vizitës studimore në Sllovaki) dhe dy ministri shqiptarë (Ministria e Arsimit dhe Sporteve, dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë). Përgjigjet nga intervistat me përfaqësuesin e qeverisë vendore/qendrore e mbështesin këtë përfundim.

## 5.2. Rezultatet e projektit dhe praktikat e mira

### Akademia e OJF-ve

**5.2.1** Të intervistuarit e vlerësuan Akademinë e OJF-ve si të dobishme dhe se i ka përmbushur kryesisht pritshmëritë e tyre. Përfaqësuesit e OJF-ve e konsiderojnë shumë të rëndësishëm investimin e tyre në forcimin e kapaciteteve, për arsye se ata janë plotësisht të vetëdijshëm që nuk mund të shënohet progres në veprimtarinë e OJF-ve në ditët e sotme, pa pasur plan të qartë të zhvillimit strategjik afatmesëm, plan të sigurimit së fondeve, procedura të manaxhimit financiar, strategji komunikimi, etj. Për më tepër, është e vështirë që të arrihet financimi nëse projekt propozimet nuk janë hartuar mirë me burime njerëzore të kualifikuara. Shumë të intervistuar u shprehën se edhe pse ata kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara

nga OJF-të ata nuk kishin njohuri specifike për sektorin deri në momentin që u punësuan në këtë sektor. Sipas tyre, vetëm në raste të rralla studimet universitare ofrojnë njohuri specifike lidhur me aspektet e organizimit, drejtimit dhe aspekte të tjera të shoqërisë civile. Zakonisht, ato japin vetëm disa përkufizime dhe parime të përgjithshme lidhur me shoqërinë civile, në varësi të fushës së studimit. Aktivitetet për forcimin e kapaciteteve të sektorit kanë qenë gjithmonë një fushë e posaçme e ndërhyrjeve nga OJF profesionale në fushën e forcimit të kapaciteteve.

**5.2.2** Objektivat e pjesëmarrjes në Akademinë e OJF-ve u arritën plotësisht. Numri i aplikimeve ka qenë rreth 2 herë më i madh se i atyre të të përzgjedhurve. Shumica e pjesëmarrësve janë Drejtorë Ekzekutivë ose Anëtarë të Bordeve Drejtuese të organizatave, që kanë mundësinë e vënies në praktikë të drejtpërdrejtë të njohurive të fituara në organizatat e tyre. Rezultatet e anketimit dhe intervistat nxorën në pah idenë se përzgjedhja e aplikantëve duhet të bazohet në organizatat që kanë misionet e ngjashme, veprimtaritë e të cilave përqendrohen në grupe të synuara të ngjashme. Kjo do të krijonte më shumë hapësirë për shkëmbim gjatë Akademisë dhe më shumë bashkëpunim në të ardhmen. Spektri i gjerë i organizatave dhe veprimtarive të tyre dobëson interesin e drejtpërdrejtë për ndarjen e përvojave dhe për krijimin e më shumë hapësirave për bashkëpunim në të ardhmen. Gjithashtu, disa të anketuar sugjerojnë që më shumë pjesëmarrës nga të njëjtat organizata ta ndjekin Akademinë, dhe jo vetëm drejtuesit e tyre apo anëtarët e Bordit.

**5.2.3** Rreth 71% e OJF-ve pjesëmarrëse në Akademi janë me qendër në Tiranë (por disa prej tyre operojnë edhe në qytete të tjera), dhe pjesa më e madhe e tyre janë organizata të reja dhe të vogla. Kjo ka përmbushur objektivin specifik të projektit për të ndihmuar OJF-të e vogla dhe të mesme në Shqipëri. Megjithatë, një ekuilibër më i mirë përfaqësimi midis OJF-ve me qendër në Tiranë dhe atyre me qendër në rrethe do të rriste efikasitetin e projektit. Anketimi me përfaqësuesit e OJF-ve jashtë Tiranës identifikoi se distanca dhe gjuha angleze ishin dy barrierat kryesore në këtë aspekt. Shumica e atyre që janë përfshirë në sektorin e OJF-ve jashtë Tiranës kanë një tjetër punë me kohë të plotë, ndërsa aktivizmi në OJF është një angazhim me kohë të pjesshme. Si rrjedhojë, është e vështirë për ta që të gjejnë hapësira për të ndjekur rregullisht programin e Akademisë. Duke njohur nevojat e mëdha që kanë OJF-të me qendër në rrethe për aktivitete që mundësojnë forcimin e kapaciteteve, të intervistuarit sugjerojnë që disa nga temat e trajnimit, që kanë më shumë lidhje me nevojat e OJF-ve me qendër në rrethe, të zhvillohen përmes platformave të të nxënimit në distancë.


**5.2.4** Asnjë përfaqësues nga institucionet e qeverisë qendrore dhe vendore nuk ishte pjesë e leksioneve të Akademisë së OJF-ve. Siç parashikohet në dokumentin e projektit, thirrja për aplikime në Akademi synonte nivelet drejtuese të OJF-ve, si drejtorët dhe anëtarët e bordit. Përsa i përket qëllimit të përgjithshëm të projektit “për të mbështetur procesin e demokratizimit dhe reformat në Shqipëri, me fokus te përmirësimi i bashkëpunimit midis sektorëve qeveritar dhe joqeveritar, përmes zhvillimit të sektorit, qëndrueshmërisë dhe transparencës, si dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile, qytetarëve dhe zyrtarëve publikë”, të dy partnerët e projektit kontribuan me anë të përfshirjes së përfaqësuesve të qeverive vendore dhe qeverisë qendrore në aktivitete të tjera që lidhen me projektin.

Rezultatet e anketimit dhe intervistat tregojnë se të dyja palët, si përfaqësuesit nga institucionet qeveritare edhe pjesëmarrësit e Akademisë, sugjerojnë se pjesëmarrja e zyrtarëve publikë në Akademi do të ishte e nevojshme për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Të anketuarit sugjerojnë se Akademia do të ishte më efektive nëse përfaqësues nga drejtoritë e buxhetit në institucione publike në nivel vendor e qendror, përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, etj., do të ishin pjesë e Akademisë, dhe nëse seancat praktike lidhur me temat përkatëse mbi rolin e qeverisë do të ofroheshin nga përfaqësues të këtyre institucioneve. Prania e tyre si lektorë gjatë leksioneve do të kishte kontribuar në bashkëpunimin ndërsektorial. Sfida për përmirësimin e aftësive, vetëbesimit dhe transparencës së sektorit është njëra anë e monedhës, ndërkohë rritja e informacionit dhe njohurive të zyrtarëve publikë për sektorin e OJF-ve ka po aq rëndësi. Gjithashtu, duke pasur parasysh barrierat e kohës dhe distancës, veçanërisht për zyrtarët publikë vendorë, një mundësi e mirëpritur për të garantuar pjesëmarrjen e tyre do të ishte organizimi i trajnimit online.

**5.2.5** Rreth 65% e të anketuarve (47 përfitues të intervistuar përmes pyetësorit dhe intervistave ballë për ballë) mendojnë se temat e trajnimit të Akademisë ishin të zgjedhura shumë mirë, ndërsa pjesa tjetër u shprehën se ato ishin të zgjedhura mirë. Komentet e tyre sugjerojnë se do të kishte qenë më mirë të kishte më pak tema dhe më shumë diskutim për tema si manaxhimi financiar i organizatave, si dhe të kishte më shumë kohë për secilën nga temat e zhvilluara. Gjithashtu, ata i vlerësojnë materialet e sugjeruara për lexim për secilën temë trajnimi.


Megjithatë, ka sugjerime për organizimin e trajnimeve në formën e workshopeve me seanca pune në grup, të cilat i kushtojnë më shumë vëmendje punës praktike dhe punës në ekip. Po ashtu, trajnimet u vlerësuan si të cilësisë së lartë, dhe shumë organizata të reja kishin vështirësi të përvetësonin të gjithë kurrikulën. Sjellja së bashku e përfaqësuesve të organizatave të mirëthemeluara me përfaqësues nga organizatat e reja ishte faktori që solli këtë rrezik. Sugjerohet që kurrikula të ofrohet e diferencuar për nivele të ndryshme, ku temat më të avancuara të zhvillohen për ato OJF që kanë përvojë të gjatë në këtë sektor. Megjithatë, asistencë teknike dhe mentorimi ndihmuan në adresimin e hendekut të njohurive në rastin e përfaqësuesve nga organizatat e reja. Të anketuarit sugjerojnë edhe ndërlidhje më të madhe të temave të Akademisë dhe me përvojat nga projektet e zbatuara nga vetë ata. (Shihni Grafikon 2).

**Grafiku 2**



Pothuajse të gjithë të anketuarit dhe të intervistuarit i kanë vlerësuar lektorët e PSH-së dhe PDCS-së si shumë profesionistë, shumë të qartë në shpjegimet e tyre dhe me aftësi të mira pedagogjike (Grafiku 3)

**Grafiku 3**



**5.2.6** Udhëzuesi i publikuar gjatë projektit, si një material burimor për pjesëmarrësit e Akademisë, u konsiderua shumë i dobishëm nga të intervistuarit. Këta të fundit i konsiderojnë shumë tërheqës shembujt, testet, mjetet dhe instrumentet praktike të ofruara për sigurimin etik të fondeve, vlerësimin e performancës në sigurimin e fondeve, përgatitjen e matricës së analizës për grupet e interesit të përfshira në advokaci, shembujt e advokacisë, instrumentet për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, etj. Ata u shprehën se e përdorin atë si material burimor sa herë që kanë nevojë (<http://partnersalbania.org/publication/zhvillimi-i-qendrueshem-dhe-perfshirja-e-oshc-ve-ne-proceset-me-pjesemarrje>)


**5.2.7** Aktivitetet e ndërthurura të projektit, si trajnimet, asistenca teknike/mentorimi dhe vizita studimore në Sllovaki u vlerësuan nga shumica e të intervistuarve. Megjithatë, rezulton se aspektet më të vlerësuara të këtyre veprimtarive ishin dy: (i) mundësia për të mësuar për procedurat dhe proceset e lidhura me manaxhimin organizativ, dhe (ii) mundësia për të vendosur kontakte dhe bashkëpunime me organizata të tjera. Gjithashtu, sugjerimet e dhëna nga të anketuarit nxjerrin në pah se ata janë të interesuar të marrin pjesë sërish në rast se Akademia riorganizohet, me qëllim vendosjen e kontakteve të reja dhe përditësimin e njohurive. Ata e shohin Akademinë më shumë si një institucion të të nxënit në vazhdim sesa si një nismë të vetme.

### Grupet e këshillimit/mbështetjes (peer coaching)

**5.2.8** Janë rreth 67% e të anketuarve që e vlerësojnë si shumë të mirë aktivitetin krijim i grupeve të këshillimit/mbështetjes dhe rreth 31% si të mirë. Ndërsa nëse pyesim vetëm të anketuarit që kishin marrë pjesë drejtpërdrejt në këtë aktivitet, rezultatet tregojnë se 54% e tyre i konsiderojnë ato si shumë të dobishme, 15% të dobishme dhe 18% disi të dobishme.

Disa nga çështjet e përmendura nga të anketuarit si të dobishme nga pjesëmarrja në këto seanca janë: identifikimi i instrumenteve të sigurimit të fondeve, marrëdhëniet midis stafit të brendshëm; rrjetëzimi dhe advokacia ndërmjet organizatave me misione të ndryshme, por të interesuara për të njëjtën kauzë të përbashkët publike, ndarja e përvojës ndërmjet organizatave, etj. (Grafiku 4)


**Grafiku 4**



**5.2.9** Asistenca teknike, e ofruar nga ekspertët e PSH-së për çështje shumë konkrete, që lidheshin me veprimtarinë e organizatave, si përgatitja e një plani strategjik afatmesëm, përgatitja e strategjisë së komunikimit, hartimi dhe shkrimi i projekt propozimeve për thirrje të caktuara, përcaktimi i politikave dhe procedurave të brendshme, hartimi i planeve për sigurimin e fondeve, etj., u konsiderua e vlefshme. Pothuajse të gjithë të intervistuarit, që përfaqësonin organizatat e trajnuara dhe të asistuar, u shprehën se kjo i ka ndihmuar për arsye se ishin organizata të reja pa përvojë konkrete, dhe rezultati i kësaj asistence ka kontribuar në strukturimin e veprimtarisë të organizatave dhe në krijimin e një prespektive të qartë për përpjekjet dhe objektivat e nevojshme. Nëpërmjet anketimit, ata që përftuan nga asistenca teknike e ofruar nga ekspertët e

projektit, u pyetën se sa e vlefshme ishte ajo për ta. 41.7% u shprehën se asistenca ishte shumë e vlefshme, 50% e konsiderojnë të vlefshme dhe 8% disi të vlefshme (Grafiku 5).

## Grafiku 5



**5.2.10** Të anketuarit sugjerojnë nevojën për më shumë asistencë teknike, veçanërisht për hartimin e projekteve, dhe për të gjitha hapat e manaxhimit të ciklit të projektit, duke përfshirë manaxhimin e projektit, zbatimin e projektit dhe raportimin. Gjithashtu, u sugjerua që e asistenca teknike të mbështetej dhe nga një fond i vogël, që mund të përdorej, mbi baza konkurrence, për të mbështetur të gjitha organizatat e reja për financimin e nismave të thjeshta, si një hap i parë drejt projekteve dhe nismave të tjera.


**5.2.11** Të gjithë të intervistuarit deklarojnë se ekspertët e PSH-së, të përfshirë në trajnim dhe asistencën teknike, ishin shumë profesionistë. Disa të intervistuar dhe të anketuar deklaruan se ata vazhdojnë të mbajnë kontakte me ekspertët e PSH-së dhe i pyesin ata për çështje të caktuara që lindin nga puna e tyre e përditshme. Disa prej tyre deklarojnë se PSH-ja është angazhuar t'i ndihmojë ata në ndjekjen e nevojave aktuale organizative.

## Vizitë studimore në Sllovaki e pjesëmarrësve të Akademisë së OJF-ve

**5.2.12** Pothuajse të gjithë të anketuarit morën pjesë në vizitën studimore të organizuar në Sllovaki. Vizita studimore është aktiviteti i vlerësuar më shumë nga të anketuarit, krahasuar me të gjitha aktivitetet e tjera të projektit. Kështu që, 85% e të anketuarve e vlerësojnë atë si një aktivitet shumë të mirë. Të anketuarit u pyetën për 4 aspekte të vizitës studimore, dhe vlerësimi është si vijon: (i) programi i vizitës u vlerësua si shumë i mirë nga 85% e të anketuarve; (ii) përvoja e organizatave të ftuara sllovake për të ndarë përvojat e tyre u vlerësua si shumë e mirë nga 80% e të anketuarve; (iii) niveli rrjetëzimit ndërmjet pjesëmarrësve të Akademisë gjatë vizitës studimore u vlerësua si shumë i mirë nga 55% e të anketuarve, dhe rrjetëzimi/kontaktet me organizatat sllovake u vlerësuan si shumë të mira nga 45% e të anketuarve (Shihni Grafikon 6).



**Grafiku 6**




Të intervistuarit shprehën vlerësimin e tyre lidhur me mundësinë për të njohur një vend anëtar të BE-së dhe eksperiencën e sektorit shoqërisë civile atje. Gjithashtu, ata vlerësuan edhe prezantimet e bëra nga organizatat dhe rrjetet sllovake, si dhe historitë konkrete dhe mësimet e nxjerra që u ndanë me vizitorët nga Shqipëria.

**5.2.13** Të anketuarit u pyetën nëse kishin përdorur në aktivitetet e organizatave të tyre deri në atë moment ndonjë model të prezantuar gjatë vizitës studimore. 37% e të anketuarve u shprehën se ata kanë përdorur të paktën një model, ndërsa 63% e tyre u shprehën se nuk kanë përdorur asnjë model të tillë (Shihni Grafikon 7).

**Grafiku 7**

Praktikat më të mira sllovake të zbatuara në Shqipëri



OJF-të që punojnë në fushën e të drejtave për aftësinë e kufizuar ndërmorën një fushatë advokacie për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ku u shprehën se kjo ishte rrjedhojë pikërisht pas përvojës që ata fituan në vizitën studimore në Sllovaki. Asnjëherë më parë në Shqipëri nuk është organizuar diçka e ngjashme për personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në këtë ditë të veçantë.


4 OJF, pjesë e programit, që u angazhuan në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, për të advokuar për Ligjin “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” në Shqipëri me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit; Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dhe Komisionin Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, u frymëzuan nga modelet e buxhetimit me pjesëmarrje të zbatuara në Banska Bystrica, gjatë vizitës së tyre studimore në Sllovaki.

Disa nga përvojat e paraqitura gjatë vizitës studimore dhe tashmë të përdorura janë bizneset sociale, modeli i diversifikimit të fondeve, modeli i funksionalitetit të qendrave komunitare, manaxhimi i brendshëm organizativ, etj. Gjithashtu, pjesëmarrësit në vizitën studimore ishin ndikuar shumë pozitivisht nga shumë aspekte të përditshmërisë në qytetet Sllovaqe, me të cilat ata u njohën gjatë vizitës, siç ishte përdorimi i koshave të mbeturinave për riciklimin e mbetjeve në të gjithë qytetin, përdorimi i produkteve miqësore për mjedisin, ulja e përdorimit të produkteve plastike, etj. Këto përvoja ishin shumë motivuese për nisma të ardhshme të organizatave.

**5.2.14** Të anketuarit u pyetën nëse planifikojnë që në të ardhmen e afërt të zbatojnë ndonjë nga përvojat e vizitës studimore në aktivitetet e organizatave të tyre. 74% e të anketuarve planifikojnë t'i përdorin këto përvoja, ndërsa 26% deklarojnë se nuk e dinë. Asnjë prej të anketuarve nuk shfaqet pesimist për përdorimin e mundshëm të praktikave dhe përvojave të ndara (Shihni Grafikon 8).

Më konkretisht, u përmendën disa modele si mundësi të ardhshme, si: qendra komunitare, rritja e numrit të shërbimeve për PAK në shkolla dhe në struktura parashkollore, dhe rritja e advokacisë për ta, instrumentet e ngritjes së fondeve të përdorura nga disa organizata sllovaqe, shtrirja e qendrave komunitare në zonat rurale, biznesi social, qendrat komunitare për familjet, sigurimi i fondeve online (crowd funding), shërbime për nxënësit dhe fëmijët në shkolla, etj.

## Grafiku 8



**5.2.15** Pjesa më e madhe e të intervistuarve theksoi se vizitat studimore ishin thelbësore për të ndarë përvojat, për të mësuar nga modelet e suksesshme, për të menduar për ide të reja, se si të përshtaten ato në vendin përkatës, për të krijuar ura bashkëpunimi në të ardhmen midis njerëzve dhe aktiviteteve, shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës që ndihmon në përshtatjen më të shpejtë, eksplorimin e ideve dhe konteksteve ndryshe; krahasimin e punëve për t'u frymëzuar nga modelet e tjera jashtë vendit për të parë zgjidhjen e problemeve nga një prespektivë tjetër; për të përdorur mjete dhe praktika për analiza, për të zhvilluar diskutimet etj.

Megjithatë, ata sugjerojnë se mund të kishte qenë më e dobishme që vizita studimore të ishte organizuar në fillim të Akademisë ose të paktën në mes të zbatimit të projektit, sepse ndjekësit e Akademisë mund të përdornin informacionin/njohuritë dhe kontaktet për të ndezur diskutime dhe për t'i zhvilluar më tej ato gjatë seancave të trajnimit dhe asistencës teknike në dobi të organizatave të tyre.

### 5.3 Efikasiteti

**5.3.1** Qëllimi i përgjithshëm i projektit për të mbështetur procesin e demokratizimit dhe reformat në Shqipëri, me fokus te përmirësimi i bashkëpunimit midis të sektorit qeveritar dhe jofitimprurës, përmes zhvillimit të sektorit, është arritur. 70 përfaqësues të OJF-ve janë trajnuar në 10 tema, në varësi të nevojave. Janë mentoruar 2 grupe me nga 12 përfaqësues të OJF-ve dhe janë asistuar teknikisht 15 OJF. Arritja e qëllimit të përgjithshëm u konfirmua edhe nga të anketuarit, ku 88% e tyre u shprehën se kapacitetet e tyre individuale janë rritur, dhe 72% e tyre pranojnë se manaxhimi i brendshëm organizativ është përmirësuar si rezultat i ndërhyrjes së projektit.

**5.3.2** Objektivi specifik për të krijuar marrëdhënie të mira me qeverinë është arritur pjesërisht. Ka nivel të ulët pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të qeverisë në veprimtaritë e projektit. Edhe të anketuarit e mbështesin këtë përfundim. Vetëm 16% e tyre pranojnë se ndiejnë më shumë vetëbesim në marrëdhënien me qeverinë. Megjithatë, përfundimi i projektit për aftësitë e përmirësuara të pjesëmarrësve të Akademisë në fushat e nevojshme për bashkëpunim me qeverinë është arritur. Udhëzuesi dhe ditët e trajnimit intensiv janë vlerësuar si shumë të dobishme nga ndjekësit. 32% e të anketuarve u shprehën se kanë shtuar veprimtaritë advokuese dhe lobuese, si rezultat i projektit, të tilla si: Advokimi për buxhete të rritura për trajtimin e nevojave/çështjeve sociale në nivel vendor; Advokimi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Advokimi për çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Disa prej tyre ishin fushatat: “Mos ma prek Valbonën”; “Ai për atë”; “Fushata kundër armëve kimike”, etj.

**5.3.3** Janë arritur rezultatet përfundimtare të parashikuara në projekt - të paktën 3 projekte janë zbatuar si rezultat i forcimit të kapaciteteve, dhe të paktën 20 OJF kanë bashkëpunuar për zgjidhjen e problemeve. Ka evidenca që tregojnë se janë të paktën 5 projekte të zbatuara në partneritet, si rezultat i pjesëmarrjes në aktivitetet e projektit, dhe 20 OJF kanë pranuar se kanë vendosur kontakte direkte, komunikim dhe bashkëpunim me pjesëmarrësit e tjerë të Akademisë. Komunikimi përmes aplikacionit WhatsApp është mjeti më i përdorshëm dhe më i shpejtë i komunikimit i përdorur.

**5.3.4** Të gjitha aktivitetet e projektit dhe të gjithë treguesit e parashikuar në projekt janë arritur plotësisht. Kjo është konstatuar përmes fazës së gjetjes së fakteve të vlerësimit, evidencave të mbledhura, si dhe opinioneve të dhëna gjatë intervistave dhe përgjigjeve të anketimit. Rezulton se cilësia dhe efikasiteti i zbatimit të aktivitetëve gjatë fazës së dytë të projektit është rritur falë disa përshtatjeve të bëra dhe instrumenteve të përdorura.

**5.3.5** Metodologjitë dhe qasjet e përzgjedhura lidhur me aktivitetet e projektit, përzgjedhjen e pjesëmarrësve të Akademisë, organizimin e webinarit si një mjet përgatitës për organizimin e vizitës studimore, aktivitetet për analizimin dhe promovimin e arritjeve të projektit, siç është konferenca kombëtare dhe përfundimtare, ishin të përshtatshme dhe patën kontribut pozitiv për të arritur objektivat e projektit deri në shkallën 90%. Gjithashtu, PSH-ja e ka manaxhuar projektin sipas marrëveshjes së nënshkruar me PDCS-në. Ajo i ka dërguar rregullisht PDCS-së raporte përshkruese dhe financiare. Ndarja e përgjegjësiave dhe roleve të PSH-së dhe PDCS-së ishte e qartë, ndërsa sinergjia ndërmjet tyre u vlerësua shumë nga pjesëmarrësit e projektit.

**5.3.6** Gjatë zbatimit të projektit funksiononte mekanizmi i monitorimit dhe vlerësimit për matjen e rezultateve të aktivitetëve të projektit. Kjo u realizua në mënyrë profesionale përmes: hartimit të planit të zbatimit të aktivitetëve, analizës së progresit nëpërmjet treguesve të matshëm dhe vlerësimit të cilësisë së zbatimit të aktivitetëve.

Kjo përvojë në vetvete ishte një element i forcimit të kapaciteteve, që iu transmetua pjesëmarrësve të Akademisë, si një metodologji e mirëstrukturuar që mund të përshtatej në punën e tyre të përditshme.

**5.3.7** Falë këtij sistemi, vlerësuesi doli në përfundimin se projekti përputhej me synimet fillestare. Kjo mund të evidentohet lehtësisht nga numri i drejtuesve dhe punonjësve në poste kyçe në OJF-të e trajnuara, asistuar/mentoruar, lidhjet e vendosura ndërmjet OJF-ve, si një strategji drejt vendosjes së shkëmbimeve dhe bashkëpunimit në të ardhmen, rezultatet e mira të vizitës studimore lidhur me mësimet e nxjerra nga OJF-të sllovaqe, si dhe kontaktet e vendosura me ta për bashkëpunim në të ardhmen. Falë këtij sistemi, treguesit e tjerë, që nuk u arritën krahasuar me synimet fillestare, ishin lehtësisht të identifikueshëm. Kjo lidhet me numrin e ulët të organizatave me vendndodhje të tjera, jo nga Tirana.

## 5.4 Qëndrueshmëria

**5.4.1** Rezultatet e projektit janë përgjithësisht të qëndrueshme. Kjo lidhet kryesisht me rezultatet që kanë efektuar përmirësimin e manaxhimit organizativ dhe aktivitetet e OJF-ve, përmes hartimit dhe planifikimit strategjik të prezantuar/përmirësuar së fundmi, manaxhimit financiar, strategjisë së komunikimit, planeve të sigurimit të fondeve, strategjisë së advokacisë dhe lobimit, etj. Shumë prej OJF-ve, që kanë aplikuar për asistencë të mëtejshme përmes seancave të mentorimit nga ekspertët e PSH-së, kanë përditësuar manualin e tyre të politikave dhe procedurave të brendshme, ose kanë hartuar politika e procedura të reja; kanë hartuar një plan të ri strategjik dhe/ose kanë rishikuar planin e tyre strategjik dhe fushat programatike; kanë ndërmarrë fushata advokacie për të kontribuar për grupet e tyre të synuara dhe për të adresuar nevojat, si dhe kanë marrë mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm falë projekt propozimeve të përmirësuar.

**5.4.2** Siç është përmendur më sipër, është realizuar edhe procesi i shqyrtimit të fakteve përmes internetit, që përfshin identifikimin e aktiviteteve të vazhdueshme të organizatave që morën pjesë në projekt gjatë vitit 2016 e në vijim. Vihet re se nga 70 OJF-të pjesëmarrëse në program, rreth 35 prej tyre kanë përditësuar faqet e internetit, 7 organizata kanë zbatuar projekte advokacie dhe lobimi, ndërsa 13 organizata janë përfshirë në programet e monitorimit të qeverisë qendrore dhe vendore, si pjesë e zbatimit të proceseve me pjesëmarrje. Kjo është një situatë shumë inkurajuese për të besuar se njohuritë dhe përvojat e ndara gjatë projektit do të vijojnë të sjellin realizimin e më shumë veprimtarive/projekteve dhe me cilësi më të lartë.

**5.4.3** Interesi dhe vlerësimi më i lartë lidhur me vendosjen e kontakteve ndërmjet OJF-ve është një tjetër shenjë inkurajuese, për të ndërmarrë nisma dhe projekte të përbashkëta. Arritja e rezultateve kryesore të projektit në kuadër të vendosjes së bashkëpunimit dhe projekteve të zbatuara bashkërisht e vërteton këtë.

**5.4.4** Për sa i përket qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit ka tre pika të dobëta: (i) Angazhimi i qeverisë për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me OJF-të e reja për çështje të interesit të përbashkët është ende i ulët; (ii) Mungesa e një programi të vazhdueshëm për forcimin e kapaciteteve, që mund t'iu përgjigjej nevojave të zyrtarëve të qeverisë dhe të OJF-ve të interesuara; (iii) Largimi i stafit, në rastet kur stafi i trajnuar punësohet në sektorë të tjerë.

## 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kapitulli i analizës së RV-së thekson përfundimet dhe sugjerimet për pothuajse çdo aktivitet të projektit. këtu po paraqesim ato më të rëndësishmet:

**6.1** Përfituesit i kanë vlerësuar shumë pozitivisht të gjitha aktivitetet, duke i cilësuar ato si shumë të përshtatshme për nevojat e OJF-ve dhe vendit. Megjithatë, për projektet në të ardhmen sugjerohet pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e zyrtarëve të qeverisë qendrore dhe vendore në të gjitha aktivitetet, veçanërisht e atyre që merren me çështje që kanë lidhje me misionin dhe veprimtarinë e OJF-ve. Një pjesë e punës praktike gjatë seancave të trajnimit mund të organizohet në mjediset e institucioneve të qeverisë vendore dhe qendrore.

**6.2** Akademia e OJF-ve është vlerësuar maksimalisht. Megjithatë, mund të jetë më efiçase nëse secili raund i Akademisë përfshin organizata me misione dhe grupe të synuara të ngjashme, me qëllim krijimin e më shumë hapësirave për shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim. Akademia mund të jetë e hapur për më shumë se një përfaqësues të organizatës. Gjithashtu, sugjerohet që Akademia të organizohet me module të niveleve të ndryshme, për arsye se organizatat e reja në këtë sektor e kanë të vështirë që të përvetësojnë një nivel të lartë njohurish. Gjithashtu, do të ishte më mirë që trajnimet të organizohen si workshope me më shumë punë praktike dhe punë në grupe, dhe më pak lexim/angaxhim jashtë sesioneve.

**6.3** Akademia duhet të funksionojë si një program i vazhdueshëm. Një hap i madh drejt qëndrueshmërisë mund të jetë prezantimi i kurrikulave për OJF-të, në shumicën e fakulteteve. Lënda mund të jetë fakultative për studentët, por ajo mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për studiuesit e rinj që të kenë njohuri për sektorin. Gjithashtu, përfaqësuesit e OJF-ve e shohin këtë si mundësi për të zbatuar edhe praktikën e të mësuarit në distancë, të paktën për temat më të rëndësishme, e cila mund t'i ndihmojnë OJF-të dhe zyrtarët vendorë të marrin pjesë.

**6.4** PDCS-ja ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për të garantuar efiçasitetin e aktiviteteve të zbatuara. Trajnuesit e PDCS-së janë vlerësuar maksimalisht për profesionalizmin e tyre, ndërsa vizita studimore ka qenë një vlerë e shtuar për projektin. Do të ishte me interes që të merrej në konsideratë organizimi i vizitës studimore në mes të Akademisë, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për të përdorur informacionin dhe njohuritë e fituara gjatë Akademisë dhe gjatë zbatimit të aktiviteteve të tjera.

**6.3** Seancat e grupeve mbështetëse (peer coaching) dhe asistencë teknike janë vlerësuar maksimalisht, por do të ishte efiçase që të alokohej një fond i vogël, për të mbështetur mbi bazën e konkurrencës, të gjitha organizatat e reja të asistuar, duke financuar nisma të thjeshta si një hap i parë drejt projekteve të tjera.

**6.8** Nxitja e partneriteteve që shkojnë përtej kohëzgjatjes së programit ka qenë një objektivi i rëndësishëm i Akademisë. Konferenca përfundimtare evidentoi se OJF-të pjesëmarrëse po zbatojnë nisma/projekte të përbashkëta dhe janë në komunikim të vazhdueshëm me njëra-tjetrën. Ndarja e praktikave të mira dhe shembujve të rrjetëzimit dhe bashkëpunimit të përmirësuar ndërmjet pjesëmarrësve dhe sektorit qeveritar ishte një nga qëllimet kryesore të konferencës. Krijimi i mjedisit mundësues për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet të dy sektorëve ishte një tjetër temë e rëndësishme diskutimi gjatë konferencës, e cila mbledhi aktorë të ndryshëm nga të dy sektorët.

Shqyrtimi i mënyrave të ndryshme për shtimin e komunikimit dhe ndarjen e ideve ndërmjet OJF-ve është me interes dhe mund të jetë shumë i vlefshëm për sektorin në të ardhmen.

## Shtojca 1: Informacione kryesore mbi aktivitetet e planifikuara dhe treguesit e arritjeve

Nr.	Aktivitetet e Planifikuara	Periudha kohore	Treguesit	Shënime	Partneri zbatues
Rezultate të përgjithshme:					
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Implementimi i projekteve konkrete si rezultat i rritjes së kapaciteteve të drejtuesve të OJF-ve dhe informacioneve të reja mbi sektorin jo fitimprurës dhe qeveritar ( të paktën 3),</li> <li>Numër konkret kontaktesh, zgjidhje problemesh ose vendosje bashkëpunimi ( të paktën 20) ”.</li> </ul>				
1.	Organizimi i Akademisë së OJF-ve	2015-2016	<p>Dy raunde Akademie, 20 pjesëmarrës në secilin raund nga të paktën 30 organizata, respektivisht; 12 module trajnimi, 4 orë për çdo trajnim;</p> <p>Raport analizë (15 faqe) mbi programin e Akademisë;</p> <p>Pyetësor mbi eksperiencat bashkëpunuese me sektorin qeveritar para dhe pas zbatimit të projektit.</p>	Modulet e parashikuara janë: Kuadri Ligjor dhe Lobimi; Formimi i rrjeteve dhe koalicioneve; Ngritje fondesh; Komunikimi Strategjik për OJF-të; Filantropia dhe zhvillimi i sipërmarrjeve sociale.	PSH+PDCCS
2.	Përgatitja e një publikimi mbi praktika të mira të bashkëpunimit midis OJF-ve dhe institucioneve qeveritare si element mbështetës për pjesëmarrësit në Akademinë e OJF-ve	2015-2016	Publikim Online dhe 100 kopje të printuara.	Një libër, në gjuhën shqipe dhe anglishte, kontribut i përbashkët i lektorëve slovakë dhe shqiptarë bazuar në një planifikim të përbashkët të metodologjisë dhe përmbajtjes, kopje të printuara për tu shpërndarë gjatë dhe pas konferencës.	PSH+PDCCS

Nr.	Aktivitetet e Planifikuara	Periudha kohore	Treguesit	Shënime	Partneri zbatues
3.	Organizimi i Vizitës Studimore të drejtuesve të OJF-ve për të mësuar nga shembujt e bashkëpunimit OJF- institucione qeveritare në Sllovaki	2015-2016	4 ditë vizitë studimore për pjesëmarrësit e suksesshëm të Akademisë .	Vizita Studimore është planifikuar të zhvillohet në qytete dhe forma të ndryshme (takime, diskutime, workshop dhe vizita në terren).	PDCS
4.	Krijimi i grupeve mbështetëse midis drejtuesve të OJF-ve	2015-2016	Dy grupe prej 10 pjesëmarrësish, takime periodike , dy orëshe, çdo dy muaj.	Pjesëmarrës vullnetarë, lehtësim profesional mbi sfidat e drejtimit gjatë ndërtimit të bashkëpunimit ndërsektorial.	PSH (PDCS në rolin e konsultuesit)
5.	Konferencë për ndarjen e eksperiencës së Akademisë së OJF-ve me përfaqësues të institucioneve qeverisëse dhe drejtuesit e rinj të sektorit	2015-2016	1 konferencë - 1 ditore, 60 pjesëmarrës, shembuj të praktikave të mira.	Gjenerimi i ideve të reja për pasurimin e programit të Akademisë.	PSH (folës drejtore e PDCS)

Nr.	Aktivitetet e Planifikuara	Periudha kohore	Treguesit	Shënime	Partneri zbatues
6.	Organizimi i Akademisë së OJF-ve për organizatat e vogla dhe të mesme	2017-2018	<p>Dy raunde të Akademisë, 16 pjesëmarrës për çdo rund, 8 module trajnimi - një ditore (6 orë/modul);</p> <p>15 faqe raport analizë mbi programin e Akademisë;</p> <p>Pyetësor mbi eksperiencën të bashkëpunimit me sektorin qeveritarë para dhe pas zbatimit të projektit.</p>	<p>Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve; Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme;</p> <p>Manaxhimi financiar- Buxheti dhe kontabiliteti; raportimi te autoritetet shtetërore;</p> <p>Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat- Ngritja e fondeve dhe filantropia;</p> <p>Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së;</p> <p>Komunikimi strategjik për OJF-të;</p> <p>Planifikimi strategjik;</p> <p>Qeverisja me pjesëmarrje;</p> <p>Mobilizimi i mbështetësve, krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve;</p> <p>Advokaci dhe Lobim;</p>	PSH
7.	Sesione konsultimi në organizata për krijimin e aktorëve të qëndrueshëm të shoqërisë civile	2017-2018	2 ditë konsultimi për 15 organizata mbi çështje të ndryshme.		PSH
8.	Eventi Final për prezantimin e arritjeve të projektit për publikun	2017-2018	1 konferencë - 1 ditore.	Prezantimi i arritjeve dhe planifikim i bashkëpunimit të mëtejshëm	PSH



Nr.	Aktivitetet e Planifikuara	Periudha kohore	Treguesit	Shënime	Partneri zbatues
9.	Program trajnimi intensiv	2017-2018	3 ditë trajnimi intensiv për secilin nga dy grupet pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve.	Përfitimi i aftësive të domosdoshme për bashkëpunimin me sektorin qeveritar	PDCS
10.	Webinar	2017-2018	Diskutime on line përpara vizitës studimore, 1 webinar për cdo grup Akademië.	Identifikimi i pritsshmërive të pjesëmarrësve përpara hartimit të programit të vizitës studimore	PDCS
11.	Organizimi i Vizitës Studimore të drejtuesve të OJF-ve për të mësuar nga shembujt e bashkëpunimit midis OJF-ve- institucione ve qeveritare slovake	2017-2018	Vizitë studimore 6 - ditore për pjesëmarrësit e suksesshëm të Akademië.	Vizita Studimore është planifikuar të zhvillohet në qytete dhe forma të ndryshme (takime, diskutime, workshope dhe vizita në terren).	PDCS

## Shtojca 2: Programi i Akademise se OJF-ve

Akademia e OJF-ve I	Akademia e OJF-ve II	Akademia e OJF-ve III	Akademia e OJF-ve IV
Panoramë e Përgjithshme: Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për Sektorin	Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve	Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve	Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve
Zhvillimi i OJF-ve - Procedurat dhe Rregullat e Manaxhimit Organizativ. Manaxhimi i Burimeve Njerëzore	Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme.	Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme.	Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme.
Zhvillimi i OJF-ve - Procedurat e Manaxhimit Financiar	Manaxhimi financiar- Buxhetimi dhe kontabiliteti; raportimi te autoritetet shtetërore	Manaxhimi financiar- Buxhetimi dhe kontabiliteti; raportimi te autoritetet shtetërore	Manaxhimi financiar- Buxhetimi dhe kontabiliteti; raportimi te autoritetet shtetërore
Manaxhimi Financiar - Buxhetimi dhe raportimi	Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat- Ngritja e fondeve dhe filantropia	Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat- Ngritja e fondeve dhe filantropia	Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat- Ngritja e fondeve dhe filantropia
Manaxhimi Financiar - Raportimi te agjencitë shtetërore	Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së.	Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së.	Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së.
Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin e biznesit	Komunikimi strategjik për OJF-të	Komunikimi strategjik për OJF-të	Komunikimi strategjik për OJF-të
Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve	Modelet e proceseve me pjesëmarrje. Qeverisja me pjesëmarrje	Planifikimi strategjik	Planifikimi strategjik
Mobilizimi i mbështetësve, bashkëpunimi sektorial dhe ndërsektorial	Mobilizimi i mbështetësve, bashkëpunimi sektorial dhe ndërsektorial, krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve	Qeverisja me pjesëmarrje	Qeverisja me pjesëmarrje
Zhvillimi i fushatave advokuese	Advokacia dhe lobimi	Mobilizimi i mbështetësve, krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve	Mobilizimi i mbështetësve, krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve
Zhvillimi i aftësive lobuese	Planifikimi strategjik	Advokacia dhe lobimi	Advokacia dhe lobimi
Komunikimi strategjik për OJF-të (Marrëdhëniet me Publikun, Zhvillimi i Imazhit dhe Mesazhit)	Vizita studimore në Sllovaki	Vizita studimore në Sllovaki	Vizita studimore në Sllovaki
Planifikimi strategjik për OJF-të			

**Shtojca 3: Informacion mbi OJF-te e asistuar dhe rezultatet e arritura**

<b>Organizatat e asistuar</b>	<b>Asistence në vendndodhje</b>	<b>Rezultatet</b>
Instituti Shqiptar për Zhvillim Politikash	“Shkrim projekt - propozimi”	2 projekte janë dorëzuar pas asistencës së ofruar nga PSH
Shoqata Internacionale për Solidaritetin, Tiranë	“Komunikimi Strategjik i OJF-ve”	Prodhim fletëpalosje/ broshura
People in Focus	“Hartimi i Planit Strategjik”	Dokument në proces
Qendra “ACT for SOCIETY”	“Zhvillimi i Planit Strategjik”	Përfunduar
EVS Tirana	“Hartimi i Planit Strategjik”	Përfunduar
Observatori Për të Drejtat e Fëmijëve	“Manuali i Politikave dhe Procedurave të Brendshme”	Përfunduar
Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)	“Manuali i Politikave dhe Procedurave të Brendshme”	Përfunduar
Open Mind Spectrum Albania	“Shkrim projekt - propozimi”	Përgatitur dhe dorëzuar një projekt propozim nën thirrjen EIDHR / EU
	“Hartimi i Planit Strategjik”	Dokument në proces
SSCI-Instituti i Europës Juglindore për Kontratën Shoqërore	“Zhvillimi i Strategjisë së Komunikimit”	Dokument në proces
Open Doors	“Komunikimi Strategjik i OJF-ve”	Dokument në proces
Qendra Shqiptare për Qeverisje Mjedisore (ACEG)	“Hartimi i Planit Strategjik”	Dokument në proces
Youth Act	“Zhvillimi i një Plan Veprimi për Advokim dhe Lobim”	Përfunduar
Fondacioni Shqiptar për Arsim	“Manuali i Politikave dhe Procedurave të Brendshme”	Dokument në proces
Të rinjtë e Urës Vajgurore	“Hartimi i Planit Strategjik”	Dokument në proces

## Shtojca 4: Citime të Rasteve dhe Praktikave të Mira

Ne si shoqatë bankare, kostot institucionale i kemi të mbuluara nga kuotat e anëtarësisë. Por ne nuk kemi fonde për zhvillimin e aktiviteteve si edukimi financiar etj. Ne kishim nevojë për një perspektivë të re si shoqatë për ngritjen e fondeve, ja pse morëm pjesë në akademinë e OJF-ve. Pjesëmarrja në Akademinë e OJF-ve na bëri të kuptojmë filozofinë e aktiviteteve jofitimprurëse dhe aspekte të cilat duhet të merrnim në konsideratë. Falë Akademisë jam e qartë në drejtimin që shoqata duhet të marrë për të garantuar fondet. Gjithashtu kam vendosur kontakte me pjesëmarrës të tjerë dhe kemi krijuar një grup në what's app ku ndajmë pyetje dhe informacione mbi punën tonë.

Junida Tafaj, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2018

Unë kam qënë pjesë e Akademisë së OJF-ve, 2015. Kjo pjesëmarrje ishte shumë e rëndësishme për mua dhe organizatën time "People in focus" që sapo ishte krijuar. Nuk kisha eksperiencën të mëparshme me shoqërinë civile dhe Akademia më ofroi informacione të bollshme mbi manaxhimin organizativ dhe financiar, sigurimin e fondeve, legjislacionin etj. Materialet dhe leksionet janë një burim informacioni shumë i vlefshëm sa herë më duhet të konsultohem me to. Gjithashtu kam vendosur kontakte të vlefshme me organizata të tjera me të cilat ndajmë vazhdimisht informacione, pyetje apo mendime. Mendoj se nëse nuk do të kisha marrë pjesë në akademinë e OJF-ve do të më ishte dashur një kohë më e gjatë për t'u integruar në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Armelia Barci, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Vlerësojmë çdo aktivitet të Projektit dhe mbi të gjitha vlerësojmë mbështetjen e vazhdueshme që Partnerët Shqipëri i kanë dhënë organizatës tonë.

Emanuela Zaimi, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Është e vështirë të thuash cili nga aspektet e projektit ishte më pozitiv pasi kishte shumë të tillë, por mbi të gjitha do të vlerësoja vendosjen e kontakteve me drejtues të OJF-ve të tjera dhe ndërveprimin me to.

Oltiana Rama, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Akademia ka qënë shumë e vlefshme për ne si organizatë pasi përfituam njohuri mbi politikën organizative dhe administrimin, manaxhimin financiar, advokimin dhe lobimin. Pas Akademisë, ne kemi mundur të zbatojmë në organizatën tonë njohuritë e mësuara për përmirësimin e procedurave të brendshme organizative dhe manualin financiar si rezultat i drejtpërdrejtë të Akademisë. Asistenca e PSH për zhvillimin e Planit Strategjik 3 vjeçar është një vlerë e shtuar për OJF-në tonë.

Armela Pengili, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Në ditën Ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, 3 dhjetor "Shoqata Ndihmoni Jetën" ndërmori një iniciativë "Advokim për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara". Kjo iniciativë u zhvillua menjëherë pas eksperiencës që morëm gjatë vizitës studimore në Sllovaki. "Duke marrë shkas nga kjo eksperiencë erdha më idenë e organizimit të një aktiviteti advokues. Në Shqipëri nuk ishte organizuar më parë event i tillë, për personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në këtë ditë të veçantë. Ishte një eksperiencë e shkëlqyer; e ngjashme me shembujt praktikë që mësova në Sllovaki. U surprizuam pa masë nga mundësitë e ndërveprimit, të mësuarit dhe bashkëpunimit me OJF-të e tjera pjesëmarrëse në Akademi"

Eglantina Shllaku, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Organizata "SHIS Albania dhe Gruaja në Zhvillim Shkodër do të zbatojnë sëbashku një projekt të mbështetur nga Bashkimi Europian gjatë periudhës 2018-2020.

Ne patëm sukses në hartimin e një projekti të përbashkët dhe zbatimin e një projekti të përbashkët me temë "Të rinjtë për mbrojtjen e mjedisit - Edukimi mjedisor dhe aktivizimi i të rinjve për Mbetjet Urbane".

Jonida Lamaj dhe Rezarta Agalliu, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Përpara se të merrja pjesë në Akademi, kisha shumë probleme në organizatën time kryesisht në aspektet e manaxhimit financiar duke përfshirë procedurat e TVSH-së si dhe në cilësinë e procedurave të brendshme. Me ndihmën e Akademisë dhe sesioneve trajnuese kemi mundur ti rregullojmë të dyja. Për më tepër kemi marrë shumë informacione të rëndësishme mbi donatorët, procedurat e aplikimit, kontakte etj të cilat janë shumë të rëndësishme për ne.

Mirela Juka, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2017

Ne jemi angazhuar në disa iniciativa advokimi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kemi organizuar një Konferencë të përbashkët "Prindërimi dhe Aftësia e Kufizuar Intelektuale"

Down Syndrome Albania dhe Shoqata Ndihamoni Jetën, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2015

Gjithashtu, "Rrjeti për Demokraci i Grave Shqipëri" dhe "Koalicioni për Zgjidhje të Lira e të Ndershme" janë angazhuar në nismën "Drejtësi për të Gjithë" i cili kontribuon për një sistem drejtësie sa më transparent, të pavaruar, llogaridhënës, profesional dhe të besueshëm në Shqipëri ku shërbimet për qytetarët por veçanërisht për grupet e marxhinalizuara të ofrohen si duhet.

Pjesëmarrës në Akademinë e OJF-ve 2015, 2016, 2017

Kam marrë pjesë në Akademinë (shkurt- korrik 2017). Ishte një eksperiencë profesionale shumë e mirë për mua dhe organizatën time. Më ka ndihmuar në strukturimin e disa prej elementëve të punës sonë të përditëshme duke nisur nga dokumentimi, përmirësimi i procedurave administrative dhe planifikimi strategjik.

Marsela Allmuca, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2017

Disa vite më parë ishin disa universitete jopublike si "Luarasi" dhe "UFO" që ofronin njohuri të ndryshme mbi OJF-të. Megjithatë shumica e tyre nuk ofronin njohuri konkrete mbi shoqërinë civile në kurrikulat e tyre. Në këtë kuadër iniciativa të tilla si Akademia e OJF-ve janë thelbësore për përfitimin dhe përditësimin e njohurive teorike dhe eksperiencave për sektorin e tretë.

Blerta Selenica, pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve, 2017

Katër (4) organizata: Partnerë për Fëmijët; Instituti i Europës Juglindore për Kontratën Sociale; Instituti Axhenda dhe SHIS Albania (pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve në 2015 dhe 2016) janë angazhuar aktivisht në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje në nivel qendror dhe kanë lobuar me dy Ministri ( Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqënies Sociale) në lidhje me buxhetin mbi Ligjin për Shërbimet e Përkujdesit Social. Përmes pjesëmarrjes së tyre në takimet me Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë kërkuar nga Parlamenti Shqiptar të mos e miratonte Ligjin për Shërbimet e Përkujdesit Social pa specifikuar më parë kostot financiare të shërbimeve.

"People in focus" dhe "DevAid Association" forcuan partneritetin dhe bashkëpunuan në zbatimin e një projekti pilot mbi panelet diellore dhe energjinë e rinovueshme në shkollat e mesme në periferi të Tiranës (Kashar). Ishte një iniciativë e suksesshme dhe të dyja organizatat janë në proces bashkëpunimi për zgjerimin e kooperimit dhe rritjen e numrit të përfituesve nga projekti.

Pjesëmarrëse në Akademinë e OJF-ve 2015

## Shtojca 5: Pyetesor

### 1. Në perceptimin tuaj, cili ishte qëllimi kryesor i Akademisë së OJF-ve, zbatuar nga PSH?

(Ju lutemi zgjidhni vetëm një alternativë)

- Forcimi i kapaciteteve të OJF-ve
- Përmirësimi i bashkëpunimit OJF- institucione qeveritare
- Shkëmbimi i eksperiencave midis OJF-ve
- Nuk e di

### 2. Në cilat prej aktiviteteve morët pjesë? (Ju lutem zgjidhni të gjitha aktiviteteve në listë në të cilat keni marrë pjesë)

- Akademia e OJF-ve
- Grupet këshilluese /mbështetëse (peer coaching)
- Sesionet konsultuese me PSH
- Vizita Studimore në Sllovaki
- Konferenca Kombëtare
- Konferenca Finale

### 3. Ju lutem vlerësoni aktiviteteve në të cilat keni marrë pjesë?

(1-4 aspak mirë; 5-6- disi mirë; 7-8- mirë; 9-10- shumë mirë)

	1-4	5-6	7-8	9-10
Akademia e OJF-ve	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Grupet këshilluese /mbështetëse	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Sesionet konsultuese me PSH	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Vizita Studimore në Sllovaki	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Konferenca Kombëtare	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Konferenca Finale	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

### 4. Sipas mendimit tuaj, kush ishin përfituesit kryesorë nga projektit?

(Ju lutem, mos zgjidhni më shumë se dy alternativa)

- Organizatat e reja në sektor
- Përfaqësuesit e institucioneve vendore
- OJF-të me eksperiencë të gjatë
- Përfaqësuesit e institucioneve qendrore
- Donatorë

**5. Ju lutem vlerësoni aspektet e mëposhtëm të Akademisë së OJF-ve?**

	aspak mirë	disi mirë	mirë	shumë mirë
Përzgjedhja dhe përmbajtja e moduleve	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Trajnerët e PSH-së	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Trajnerët e PDCS-së	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

**6. A mendoni se ishte e mjaftueshme koha për çdo modul?**

Po  Jo  Nuk e di

**7. Nëse keni marrë pjesë në seksionet e trajnimit nga kolegët, ju lutem vlerësoni nivelin e përfitimeve dhe përmendni në terma konkretë ç`farë keni përfituar?**

- Shumë të vlefshëm
- Të vlefshëm
- Disi të vlefshëm
- Aspak të vlefshëm

Çështje konkrete të përfituara: \_\_\_\_\_

**8. Nëse keni përfituar nga seksionet konsultuese me PSH, ju lutem vlerësoni në çfarë niveli ishte e vlefshme për ju dhe ç`farë keni përfituar konkretisht nga asistenca?**

- Shumë të vlefshëm
- Të vlefshëm
- Disi të vlefshëm
- Aspak të vlefshëm

Çështje konkrete të përfituara: \_\_\_\_\_

**9. Nëse keni marrë pjesë në Vizitën Studimore në Sllovaki, ju lutem vlerësoni si vijon:**

	disi mirë	mirë	shumë mirë
Programi	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Ekspierenca e prezantuar nga OJF sllovaqe	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Kontaktet/rrjetëzimi me OJF-të shqiptare	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Kontaktet/rrjetëzimi me OJF-të sllovaqe	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

**10. A keni përdorur ndonjë nga modelet që ju prezantuan gjatë Vizitës Studimore?**

Po  Jo

Ne se po, ju lutem përmendni konkretisht \_\_\_\_\_

**11. A planifikoni të zbatoni ndonjë nga iniciativat të cilat ju lanë më shumë përshtypje?**

Po  Jo  Nuk e di

Nëse po çfarë konkretisht \_\_\_\_\_

**12. Ju lutem përmendni cilat ishin disa nga përfitimet kryesore nga projekti?**

- Kapacitete më të mira individuale
- Më shumë vetbesim në raport me institucionet publike
- Përmirësim i organizimit të brendshëm
- Rritje e bashkëpunimit me institucionet publike
- Rritje e pjesëmarrjes në lobim dhe advokim
- Projekte të përbashkëta me organizata të tjera pjesëmarrëse në Akademi

Të tjera \_\_\_\_\_

**13. Ju lutem, sipas mendimit tuaj, çfarë do të donit të ishte ndryshe nëse akademja do të organizohej sërish në të ardhmen?**

---

---

---



**Shtojca 6: Lista e intervistave**

<b>Organizata/Fondacioni</b>	<b>Vendodhja</b>
Down Syndrome Albania	Tiranë
Act for Society	Tiranë
Projekte Nderkombetare Vullnetare	Tiranë
People in Focus	Tiranë
Strehëza për Gra dhe Vajza	Tiranë
Shoqata Shqiptare e Bankave	Tiranë
Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi - IDRA	Tiranë
Rinia për Integrim dhe Sensibilizim - RIAS	Tiranë
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)	Tiranë
Qendra Shqiptare për Qeverisje Mjedisore	Tiranë
Ndihmoni Jetën	Tiranë
Legambiente	Vlorë
Fondacioni Gjirokastra	Gjirokastër
Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (MEDPAK)	Librazhd
Qendra Konsumatori Shqiptar	Durrës
Komiteti Rinor	Lezhë
Docas Aid International, Albania	Korçë
Kujdesi Shëndetsor Familjar - "Mary Potter"	Korçë
Ura të Reja	Urë Vajguore
Mjedisi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm	Lezhë
Partnerët Shqipëri	Tiranë
Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki	Sllovaki

